



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite - Ministry of Labour and Social Welfare

Udhëzues për menaxhimin e rastit të fëmijëve në punë

Prishtinë 2020

Falënderime

Ky Udhëzues është hartuar me mbështetjen e projektit “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përshejtimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” i cili financohet nga Departamenti i Punës i SHBA-së dhe menaxhohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës¹.

Udhëzuesi përqendrohet në përvojën ekzistuese të profesionistëve, përfshirë Qendrat për Punë Sociale, OJQ-të vendore të cilat janë aktive në mbrojtjen e fëmijëve, ONP-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në Kosovë, në adresimin e riintegritimit afatgjatë social dhe ekonomik të fëmijëve të angazhuar në punë.

¹ Konceptuar në vitin 2016, projekti MAP16 financohet nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara dhe menaxhohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Projekti synon të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë kritike të nevojshme për të informuar zgjedhjet e politikave dhe për të rritur kapacitetin e partnerëve globalë, rajonalë dhe kombëtarë për t'i mbështetur masat për të zvogëluar punën e fëmijëve dhe punën e detyruar www.ilo.org/map16
Financimi sigurohet nga Departamenti i Punës i Shteteve të Bashkuara nën marrëveshjen bashkëpunuese me numër IL - 30147-16-75 - K - 11. Njëqind për qind e kostove totale të projektit MAP16 financohen me fonde federale, për një total prej 22,400,000 USD.

Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara, dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara

Përmbajtja

Shkurtesat	7
Përkufizimet e termave kryesorë	8
Qëllimi dhe fushëveprimi i këtij udhëzuesi	12
Pjesa 1: Të kuptuarit e punës së fëmijëve	15
1.1 Përkufizimi i punës së fëmijëve	16
1.2 Shkaqet e punës së fëmijëve	19
1.3 Pasojat e punës së fëmijëve	21
Pjesa 2: Korniza ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë	25
2.1 Korniza ligjore për mbrojtjen e fëmijëve	26
2.2 Përgjegjësitë ligjore të palëve kryesore të interesit	40
Pjesa 3: Përmbledhje e procesit të menaxhimit të rasteve	49
3.1 Çfarë nënkupton menaxhimi i rastit?	50
3.2 Cilat janë parimet udhëheqëse në menaxhimin e rastit?	50
3.3 Rëndësia e mekanizmave për koordinim	53
Pjesa 4: Procedurat standarde të veprimit për menaxhimin e rasteve për fëmijët në punë	55
4.1 Çështjet kryesore për shqyrtim në menaxhimin e rasteve të fëmijëve	56
4.2 Hapat kryesorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në punë	58
4.3 Udhëzime për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në punë	59
Hapi 0: Identifikimi i fëmijës së cenueshëm	59
Hapi 1: Referimi i fëmijës në Qendrën për Punë Sociale	60
Hapi 2: Ekzaminimi, regjistrimi dhe vlerësimi i rrezikut	60

Hapi 3: Vlerësimi i rastit, përfshirë vlerësimin fillestar dhe gjithëpërfshirës	61
Hapi 4: Plani i shërbimeve	67
Hapi 5: Zbatimi i planit të shërbimit, rishikimi dhe monitorimi i rastit.....	69
Hapi 6: Vlerësimi i zbatimit të planit të shërbimeve.....	70
Hapi 7: Mbyllja e rastit	72

Pjesa 5: Formularët e menaxhimit të rasteve për fëmijët në punë.75

Formulari 1: Referimi i rastit	76
Formulari 2: Caktimi i menaxherit të rastit.....	77
Formulari 3: Vlerësimi i rastit.....	79
Formulari 4: Plani i shërbimeve	85
Formulari 5: Vlerësimi i zbatimit të planit të shërbimeve.....	88
Formulari 6: Rishikimi i planit të shërbimeve.....	92
Formulari 7: Referimi intern.....	95
Formulari 8: Fleta përcjellëse e kontaktit dhe puna në rast.....	96
Formulari 9: Mbyllja e rastit	97

Shkurtesat

UA	Udhëzim Administrativ
MR	Menaxheri i Rastit
TMR	Tryeza multidisiplinare për ndihmë në Menaxhimin e Rastit
PF	Puna e Fëmijëve
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
FVT	Fëmija Viktimë e Trafikimit
QPS	Qendra për Punë Sociale
ZP	Zyra e Punësimit
PRrF	Puna e Rrezikshme e Fëmijëve
HIV	Virusi i Mungesës së Imunitetit të Njeriu
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
PNEPF	Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve
KDM	Kodi i Drejtësisë për të Mitur
PK	Policia e Kosovës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OZHQ	Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
SLL	Sistemi i Llogarive Kombëtare të Kombeve të Bashkuara
EPRBM	Ekipet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar
GPT	Grupi Punues Teknik
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
QAP	Qendra e Aftësimin Profesional
MV	Mbrojtësi i Viktimave
FKPK	Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve

Përkufizimet e termave kryesorë

Përkufizimet kryesore që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve nga format më të këqija të punës së fëmijëve, siç përshkruhet në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, përfshijnë:

Fëmijët në nevojë - nënkupton çdo fëmijë, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për mbrojtje.

Fëmijët në situatë rruge – nënkupton fëmijën i cili është në rrugë duke lypur lëmshë, duke kryer punë të ndryshme, duke shitur sende me vlerë të ulët ose çfarëdo forme tjetër, qoftë vetëm ose me prindin/prindërit.

Puna e ndaluar për fëmijë - është puna apo aktiviteti i cili dëmton sigurinë, shëndetin, moralin dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës, si rezultat i mungesës së përvojës dhe njohurive për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës;

Format e rrezikshme të punës së fëmijës - janë punë që mund të rezultojnë me vdekje, lëndime (shpeshherë të përhershme) apo sëmundje (shpeshherë të përhershme) të fëmijës, si pasojë e mospërshtatjes së natyrës së punës me moshën dhe zhvillimin psikofizik të fëmijës dhe sigurisë së pamjaftueshme në vendin e punës;

Dhunë ndaj fëmijës – nënkupton çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

Dhuna psikologjike - nënkupton veprime ose mosveprime që shkaktojnë dëme në zhvillimin fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës, dhe që përveç të tjerash, rezultojnë në kufizimin e lirisë së lëvizjes, degradimin, kërcënimin, frikësimin, diskriminimin, përqeshjen ose forma të tjera të trajtimit armiqësor ose refuzues.

Dhuna fizike - nënkupton veprime ose mosveprime që shkaktojnë dëme ose lëndime fizike të fëmija, përfshirë të gjitha format e ndëshkimit trupor të cilat nuk janë aksidentale.

Neglizhenca - nënkupton neglizhencën dhe moskryerjen e detyrave dhe përgjegjësive për t'u kujdesur, për ta mbrojtur në mënyrë të duhur dhe për ta monitoruar fëmijën, si dhe për ta

siguruar përmbushjen e nevojave themelore për zhvillimin fizik dhe intelektual, emocional dhe social të fëmijës.

Abuzimi - nënkupton çdo veprim ose mosveprim, i qëllimshëm apo me paramendim, i kryer nga prindi ose kujdestari, ofruesi i kujdesit ose ndonjë person tjetër në pozitën e personave të besueshëm ose autoritetit që shkakton ose ka të ngjarë të shkaktojë dëme fizike, psikologjike, sociale ose emocionale ndaj një fëmije.

Shfrytëzimi nënkupton:

- shfrytëzimin seksual, përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve për qëllime komerciale në kuadër të prostitucionit të fëmijëve, shfrytëzimin seksual të fëmijëve për turizëm, pornografi dhe trafikimin e fëmijëve për këto qëllime;
- shfrytëzimin ekonomik, përfshirë format më të rënda të punës për fëmijën, lypsaria, fëmija në punë dhe fëmija në punët e shtëpisë, që nuk janë në përputhje me legjislacionin dhe instrumentet ndërkombëtare në fuqi, si dhe
- format tjera të shfrytëzimit, përfshirë trafikimin dhe të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjen e organeve apo qelizave.

Abuzimi seksual i fëmijëve nënkupton:

- detyrimin, angazhimin, ose nxitjen dhe nxitjen e fëmijës për të marrë pjesë në aktivitete seksuale;
- Detyrimin, angazhimin ose nxitjen në aktivitete seksuale me fëmijën, duke keqpërdorur pozitën e besimit ose autoritetin e prindit, kujdestarit ose ofruesit të kujdesit;
- Aktivitetin seksual, i cili nënkupton marrëdhënie seksuale dhe çdo formë tjetër e kryer nga, me, dhe para fëmijës, ku prania ose pjesëmarrja e fëmijës është për qëllim të kënaqësisë seksuale të personit tjetër.

Prostitucioni me fëmijë - nënkupton përdorimin e një fëmije për veprimtari seksuale, me ç'rast në këmbim të përfshirjes në veprimtari seksuale të fëmijës, ofrohen ose premtohen si pagesë paratë ose çdo formë tjetër shpërblimi ose kompensimi, pavarësisht nëse ajo pagesë, ai premtim ose shpërblim i bëhet fëmijës ose një pale të tretë.

Pornografia me fëmijë nënkupton:

- çdo material që paraqet pamje vizuale të një fëmije të përfshirë në sjellje seksuale të dukshme, të simuluar, apo reale;
- çdo pasqyrim të organeve seksuale të fëmijës për qëllime parësore seksuale; çdo material që e pasqyron në mënyrë vizuale çdo person në dukje fëmijë të përfshirë në sjellje

seksuale të dukshme të simuluar ose reale ose çdo pasqyrim të organeve seksuale të çdo personi në dukje fëmijë, për qëllime kryesisht seksuale; ose imazhet reale të një fëmije të përfshirë në sjellje të dukshme seksuale ose imazhet reale të organeve seksuale të fëmijës për qëllime kryesisht seksuale.

Trafikimi i fëmijëve - nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose pranimin e fëmijës, me ose pa mjete të kërcënimit ose përdorimit të forcës, formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të pushtetit apo pozitës së dobësisë, ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e prindërve, kujdestarit, ofruesit të kujdesit ose ndonjë personi tjetër që ka kontroll mbi fëmijën, për qëllime të shfrytëzimit.

Turizmi seksual i një fëmije - nënkupton shfrytëzimin seksual të fëmijës nga një person ose persona që udhëtojnë nga rrethi i tyre në shtëpi, rajoni gjeografik në shtëpi, apo nga vendi i origjinës, në mënyrë që të kenë kontakt seksual me fëmijën. Turizmi seksual i fëmijës përfshin përdorimin e akomodimit, transportit dhe shërbime të tjera që lidhen me turizmin që lehtësojnë kontaktin me fëmijën dhe i mundësojnë kryesit që të mos bie në sy të popullata dhe mjedis.

Familja në nevojë - nënkupton çdo familje, kur njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit, u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës, në rrethana kur fëmija është duke pësuar dëmtim serioz për shkak të lënies pas dore, abuzimit nga ana e prindit/ve ose kujdestarit të tij, për shkak të paaftësisë së prindit ose prindërve apo kujdestarit që të përkujdesen për të në mënyrë adekuate, ose i është ekspozuar mundësisë që të përjetojë diçka të tillë.

Përfaqësuesi ligjor - nënkupton prindin apo kujdestarin i cili, brenda përgjegjësisë që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, i mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës.

Parandalimi - nënkupton një sërë masash të përbashkëta të ndërhyrjes së hershme edukative, arsimore, sociale dhe ligjore në favor të fëmijës dhe familjes, që është i kërcënuar apo në rrezik në zhvillimin e tij, në mënyrë për t'i rivendosur kushtet për zhvillimin e tij, për t'i parandaluar aktet e keqtrajtimit apo për të parandaluar përsëritjen e tyre duke mundësuar rivendosjen e kompetencave prindërore-rehabilitimin e kompetencave prindërore.

Mbrojtja e fëmijës - nënkupton aktivitetet që ndërmerren për t'i mbrojtur fëmijët që janë duke vuajtur, ose ka të ngjarë të vuajnë nga një rrezik serioz, si dhe çdo veprim që siguron fëmijën të jetojë në një familje apo mjedis tjetër të sigurt, ku mbrohet jeta dhe shëndeti dhe respektohen të drejtat e tij, ku sigurohet edukimi, arsimi dhe zhvillimi, duke i mbrojtur ata nga çfarëdo lloj dhune, shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, keqtrajtimi, eksploatimi, lënie pas dore, abuzimi dhe shfrytëzimi, në çdo kontekst, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijës dhe praktikën e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjenitale, martesë e fëmijës dhe abuzimi.

Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve - nënkupton çdo shërbim për ofrimin e kujdesit social ose psikosocial, ndihmës juridike, përfaqësimit ligjor, kujdesit shëndetësor, ndihmës ar-

simore dhe kulturore ose, në rrethana të jashtëzakonshme, ndihmës materiale për fëmijën në nevojë.

Profesionistët për mbrojtjen e fëmijëve - nënkupton të gjithë personat, të cilët brenda mandatit të punës së tyre dhe në kontekstin e punës së tyre, janë në kontakt me fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje, ose kanë detyrë t'i përmbushin nevojat e fëmijës sipas këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, standardi vendor apo ndërkombëtar.

Menaxher i rastit - nënkupton zyrtarin përgjegjës i caktuar nga Organi i Kujdestarisë për menaxhimin e rastit të fëmijës, i cili, **në bashkëpunim me akterët relevantë**, vlerëson nevojat e fëmijës dhe harton planin e përkujdesjes.

Qendra për Punë Sociale (QPS) - nënkupton institucionin publik profesional, të nivelit komunal, kompetent edhe për mbrojtjen e fëmijës në nevojë.

Tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve - nënkupton ekipin multidisiplinar, që përfshinë grup profesionistësh nga institucionet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës dhe akterë tjerë që përfaqësojnë një shumëllojshmëri të disiplinave, të cilët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës, ndërveprojnë dhe koordinojnë përpjekjet e tyre për t'i trajtuar rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pas dore të tyre në bazë të interesit më të mirë të fëmijës. Fëmija dhe familja mund të jenë pjesëmarrës në tryeza.

Tjera përkufizime të rëndësishme

Interesi më i mirë i fëmijës: në të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta. Kjo kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për të promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen sociale të fëmijës.

Interpretimi i interesit më të mirë të fëmijës duhet të jetë në tërësi në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, si dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Konventa.

Menaxhim i rastit: është një mënyrë e organizimit dhe kryerjes së punës për t'i adresuar nevojat individuale të fëmijës (dhe familjes së tij) në mënyrë të përshtatshme, sistematike dhe me kohë, nëpërmjet mbështetjes dhe/ose referimeve të drejtpërdrejta (Global Protection Cluster, 2014).

Referim i rastit: është procesi i të kërkuarit në mënyrë zyrtare të shërbimeve për një fëmijë ose familjen e tij nga një agjenci tjetër përmes një procedure të përcaktuar.

Qëllimi dhe fushëveprimi i këtij udhëzuesi

Qëllimi kryesor i këtij udhëzuesi është standardizimi i praktikës së menaxhimit të rasteve për fëmijët në punë, dhe mbështetja e e Qendrave për Punë Sociale në aplikimin e praktikave efektive të menaxhimit të rasteve. Udhëzuesi plotëson udhëzimet ekzistuese për menaxhimin e mbrojtjes së fëmijëve duke konsoliduar udhëzimet procedurale që ofrohen në kornizën ligjore. Përmbajtja bazohet edhe në përvojën e deritanishme të QPS-ve, si dhe organizatave të ndryshme të përfshira në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në punë.

Udhëzuesi, para së gjithash, i drejtohet punëtorëve socialë (në QPS si dhe në OJQ-të të cilat ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijëve) si dhe mbikëqyrësve të shërbimeve sociale për fëmijë (në nivel të QPS-ve, autoriteteve komunale dhe atyre qendrore).

Menaxhimi efektiv dhe profesional i rasteve të fëmijëve në punë nënkupton bashkërendim të veprimeve ndërmjet agjencive në sektorin e mirëqenies, edukimit, shëndetësisë, punësimit, sigurisë e drejtësisë, prandaj nevojitet:

- të kuptuarit e efekteve afatshkurtra dhe afatgjata të punës së fëmijëve, përfshirë rreziqet që ato i paraqesin fëmijës dhe familjes së tij;
- të kuptuarit e parimeve themelore të sistemit të menaxhimit të rasteve;
- bashkëveprim i ngushtë me fëmijën dhe familjen e tij, duke siguruar gjithmonë interesin më të mirë të fëmijës/viktimës si prioritet;
- bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet agjencive, sepse shërbimet kur ofrohen nga agjenci individuale në izolim humbasin elementin e efektivitetit;
- ndjeshmëri kulturore;

Nisur nga kjo, udhëzuesi trajton konceptet themelore, shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve, kornizën ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, si dhe procesin e menaxhimit të rasteve, me theks në procedurat standarde të veprimit për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në punë.

Pjesa 1

Përshkruan konceptet themelore lidhur me punën e fëmijëve, përfshirë punën e lejuar, punën e fëmijëve dhe format më të rënda të punës së fëmijëve. Gjithashtu kjo pjesë ofron një pasqyrë të faktorëve që kontribuojnë në punën e fëmijëve dhe ndikimin e punës së fëmijëve te fëmija personalisht, familja e tij dhe shoqëria në përgjithësi.

Pjesa 2

Përshkruan kornizën ligjore dhe institucionale në Kosovë, të autorizuar për të vepruar dhe bashkëpunuar në identifikimin, tërheqjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve të angazhuar në punë.

Pjesa 3

Ofron një pasqyrë të procesit të menaxhimit të rasteve, përfshirë parimet themelore të procesit në fjalë.

Pjesa 4

Thekson konsideratat specifike për menaxhimin e rasteve të fëmijëve, përshkruan dimensionet e ndërlidhura të procesit të menaxhimit të rasteve dhe ofron udhëzime për zbatimin e të gjitha hapave në procesin e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në angazhuar në punë.

Pjesa 5

Përfshin setin e plotë të formave të menaxhimit të rasteve për fëmijët në punë, të miratuar nga MPMS-ja në mars të vitit 2020 për përdorim zyrtar nga Qendrat për Punë Sociale.

PJESA 1

TË KUPTUARIT
E PUNËS SË FËMIJËVE

1.1 Përkufizimi i punës së fëmijëve

Jo të gjitha punët që kryejnë fëmijët dhe adoleshentët duhen të klasifikohen si punë e fëmijëve dhe duhet te tentohen të eliminohen. Pjesëmarrja e fëmijëve ose e adoleshentëve në punë që nuk ndikon në shëndetin dhe zhvillimin e tyre personal, ose që nuk ndërhyjnë në shkollimin e tyre, në përgjithësi konsiderohet si pozitive. Kjo përfshin aktivitete të tilla si të ndihmshëm prindërit rreth shtëpisë, të ndihmshëm në një biznes familjar ose të fitosh para jashtë orëve të mësimin dhe gjatë pushimeve shkollore. Për t'u cilësuar si punë e lejuar për fëmijë, e gjithë natyra dhe kushtet e detyrave të lartpërmendura duhet të mos paraqesin rrezik dhe të jenë të përshtatshme për moshën dhe aftësitë psikofizike të një fëmije dhe nuk duhet të pengojnë shkollimin e fëmijës. Këto lloje aktivitete kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve dhe në mirëqenien e familjeve të tyre dhe gjithashtu u sigurojnë atyre aftësi dhe përvojë, si dhe i ndihmojnë në përgatitjen e tyre për të qenë anëtarë produktivë të shoqërisë gjatë jetës së tyre si të rritur. Kështu, **puna e lejuar** për fëmijët mbi moshën minimale për llojin e punës në fjalë konsiderohet si pjesëmarrje në aktivitete ekonomike jo të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës, dhe veçanërisht që nuk e pengon atë të ndjekë shkollimin dhe të luaj.

Termi “**punë e fëmijëve**” shpeshherë përkufizohet si punë që privon fëmijërinë e fëmijës, potencialin dhe dinjitetin e tij dhe që është e dëmshme për zhvillimin fizik dhe mendor. I referohet punës që:

- mendërisht, psikologjikisht, shoqërisht dhe moralisht është e dëmshme dhe e rrezikshme për fëmijët; dhe
- ndërhyjnë në shkollimin e fëmijëve duke: (a) i privuar ata nga mundësia për të ndjekur shkollën, (b) i detyruar ata të lënë shkollën para kohe, ose (c) i detyruar ata të ndjekin shkollën në kushte shumë të vështira.

Se a mund të quhen format e veçanta të “punës” si “punë e fëmijëve” varet nga mosha e fëmijës, lloji dhe orari i punës që ai bën, kushtet në të cilat kjo punë kryhet dhe synimet e vëna nga secili vend.

Përderisa puna e fëmijëve merr shumë forma të ndryshme, prioritet është të eliminohen pa vonesë format më të këqija të punës së fëmijëve, siç përcaktohet në nenin 3 të Konventës së ONP-së për format më të këqija të punës së fëmijëve nr. 182 (1999). **Format më të këqija të punës së fëmijëve** përfshijnë:

- a) të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi skllavëruar dhe bujkrobëria dhe puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimi pa dëshirë ose të detyruar për përdorim në konflikte të armatosura;
- b) përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për prostitucion, për prodhim pornografik ose për shfaqje pornografike;

- c) përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike sikundër janë përkufizuar në traktatet përkatëse ndërkombëtare;
- d) punët të cilat, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhen mund të rrezikojnë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

Shtetet duhet të përcaktojnë **që tri** kategoritë e para (a, b dhe c) të formave më të këqija të punës së fëmijëve janë vepra penale. Kategoria e katërt (d) cilësohet si punë e rrezikshme e fëmijëve dhe i referohet punës që ka gjasa të rezultojë në vdekjen e fëmijës, lëndimin (shpeshherë për gjithë jetën) ose sëmurjen (shpeshherë për gjithë jetën) për shkak të natyrës së punës ose si pasojë e vendit jo të sigurt të punës, standardeve të ulëta të sigurisë dhe shëndetit dhe kushteve dhe rregullimeve të punës. Sipas paragrafëve 3 dhe 4 të Rekomandimit të ONP-së 190 (1999), në përcaktimin e llojeve të punës të përmendura në nenin 3(d) të Konventës, dhe në identifikimin e vendit ku ato ekzistojnë, vëmendje duhet t'i kushtohet, ndër të tjera: (a) punës dhe veprimtarive që ekspozojnë fëmijët ndaj abuzimit fizik, psikologjik apo seksual; (b) punës nën tokë, nën ujë ose në lartësi të rrezikshme ose në hapësira të kufizuara; (c) punës me makineri, me pajisje dhe me vegla të rrezikshme ose asaj që përfshin përpunimin ose transportin me dorë të ngarkesave të rënda; (d) punës në një mjedis të pashëndetshëm, i cili mund të ekspozojë për shembull, fëmijët ndaj lëndëve, faktorëve ose proceseve të rrezikshme ose ndaj temperaturave, niveleve të zhurmës ose dridhjeve të rrezikshme, që dëmtojnë shëndetin e tyre; (e) punës në kushte veçanërisht të vështira, siç është puna me orë të zgjatura ose gjatë natës ose puna që nuk lejon kthimin në shtëpi çdo ditë, ose puna në të cilën fëmija është i mbyllur në mënyrë të paarsyeshme në ambientet e punëdhënësit.

Në përputhje me ONP C 182, puna e detyruar, rekrutimi i fëmijëve për përdorim në konflikt të armatosur, trafikimi i fëmijëve, përdorimi i fëmijëve për prostitucion dhe pornografi, dhe aktivitetet e paligjshme në Kosovë janë të ndaluara nga Kodi Penal.

Sa i përket punës së rrezikshme për fëmijët, versioni i parë i listës së punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë është përgatitur me mbështetjen e ONP-së gjatë periudhës 2005-2007, dhe ka hyrë në fuqi ligjërisht si Udhëzim Administrativ i Qeverisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rrezikshme për Fëmijë në Kosovë (UA 17/2008). Udhëzimi Administrativ rendit (a) sektorët e rrezikshëm dhe (b) aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që duhet të ndalohen si çështje parësore. Në vitin 2013, UA 17/2008 u zëvendësua me UA 05/2013, duke përditësuar listën e punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë².

Aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme përfshijnë:

- punën gjatë natës (ndërmjet orës 20:00 dhe 6:00);
- ngritjen dhe bartjen e kohëpaskohshme të peshave të rënda mbi 15 kg (M) dhe 10 kg (F);
- ngritjen dhe bartjen e vazhdueshme të peshave mbi 10 kg (M) dhe 5 kg (F);
- punën në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe vende të mbyllura;
- punën në lartësi mbi 2 m;

² Në listën e rishikuar u shtua sektori i ndërtimit, si dhe disa aktivitete për sektorin e bujqësisë

- punën që mund të shkaktojë dëme në shëndetin e fëmijës për shkak të ekspozimit ndaj temperaturave ekstreme të larta apo të ulëta, ose ndaj zhurmës dhe dridhjes;
- ekspozimin ndaj substancave biologjike, kimike dhe toksike³, dhe ekspozimin ndaj radioaktivitetit.

Sektorët dhe aktivitetet specifike të rrezikshme⁴ përfshijnë:

- Sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë
 - Operimi me makina bujqësore;
 - Puna me pesticide dhe spërkatja;
 - Korrjet;
 - Punë të rënda fizike në fusha dhe hapja e gropave për pyllëzim ose mbjellje të pemëve;
 - Prerja e druve dhe përpunimi i drurit;
 - Puna në thertore dhe në industrinë e përpunimit të mishit (prerja, transporti dhe shitja e kafshëve);
 - Gjuetia;
 - Grumbullimi i frutave malorë dhe vjelja e pemëve;
 - Puna në serrë;
 - Puna në bletishte.
- Punën në rrugë
 - Bartja e peshave të rënda;
 - Pastrimi i parafangove të automjeteve në komunikacion;
 - Transporti i mallrave me karrocë bartëse;
 - Kërkimi i lëmoshës.
- Punën në ndërtimtari
 - Gërmimi i dheut;
 - Transportimi i peshave të rënda;
 - Sitja e rërës dhe çimentos;
 - Puna në skela;
 - Përpunimi i metaleve.
- Punën në deponi të mbeturinave
 - Hulumtimi, grumbullimi dhe bartja e mbeturinave.
- Punën në eksploatimin e pasurive natyrore.

Meqenëse angazhimi i fëmijëve në punët e shtëpisë nuk është i rregulluar në Kosovë, përkufizimet e Treguesit 2 për matjen e punës së fëmijëve me qëllim të raportimit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-së)⁵, mund të aplikohen (krahas UA 05/2013) për identifikimin e fëmijëve të përfshirë në punën e fëmijëve, vlerësimin e rrezikut, si dhe në raportimin për OZHQ-të. Treguesi i parë bazohet në kufirin e prodhimit të vendosur nga Sistemi i Kombeve të Bashkuara për Llogaritë Kombëtare (SNA) dhe i dyti bazohet në kufirin e përgjith-

3 Gjithashtu është siguruar lista e detajuar e substancave biologjike, kimike dhe toksike

4 Rreziqet e ndërlidhura dhe efekti i tyre në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve sigurohen për secilin aktivitet në sektorët përkatës

5 Konferenca e 20-të Ndërkombëtare e Statistikave të Punës. Rezoluta për të ndryshuar Rezolutën e 18-të të ICLS në lidhje me statistikat e punës së fëmijëve. ILO. Gjenevë, Tetor 2019

shëm të prodhimit. Treguesi 1 kufizon kornizën e referencës për aktivitetin ekonomik, ndërsa Treguesi 2 e shtrin atë për të përfshirë si aktivitetin ekonomik ashtu edhe shërbimet shtëpiake të papaguara, domethënë prodhimin e shërbimeve shtëpiake dhe personale nga një anëtar i familjes për konsum brenda familjes së tyre, që zakonisht quhen «punët e shtëpisë».

- Treguesi 2: Përqindja dhe numri i fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të angazhuar në aktivitete ekonomike dhe punët e shtëpisë në ose mbi pragjet e orarit specifik për moshën (mbi kufirin e prodhimit të përgjithshëm):
 - Puna e fëmijëve për grupmoshën 5 deri në 11 vjeç: fëmijët që punojnë së paku 1 orë në javë në aktivitet ekonomik dhe/ose janë të përfshirë në shërbime shtëpiake të papaguara për më shumë se 21 orë në javë;
 - Puna e fëmijëve për grupmoshën 12 deri në 14 vjeç: fëmijë që punojnë për të paktën 14 orë në javë në aktivitet ekonomik dhe/ose janë të përfshirë në shërbime shtëpiake të papaguara për më shumë se 21 orë në javë;
 - Puna e fëmijëve për grupmoshën 15 deri në 17 vjeç: fëmijët që punojnë për më shumë se 43 orë në javë në aktivitet ekonomik.⁶

1.2 Shkaqet e punës së fëmijëve

Ka shumë arsye që i shtyjnë fëmijët në fuqinë punëtore, por faktori më i rëndësishëm është varfëria. Familjet e varfra i vendosin fëmijët e tyre të punojnë për t'i plotësuar të ardhurat e pakta të familjes së tyre. Varfëria është shkak dhe pasojë e punës së fëmijëve. Varfëria dhe puna e fëmijëve janë përbërësit kryesorë të një “ekuilibri të ulët ekonomik” në familje, komunitet dhe nivel vendi. *Puna e fëmijëve është prandaj një pikë e rëndësishme hyrëse për uljen e varfërisë dhe masat e mbrojtjes sociale, madje edhe në mesin e më të varfërve, për të cilët zgjidhjet e qëndrueshme janë të vështira për t'u identifikuar (përtej ndihmës së drejtpërdrejtë sociale).*

Përveç varfërisë, shumë faktorë të tjerë kontribuojnë në punën e fëmijëve:

- **Qëndrimi mbështetës ndaj punës së fëmijëve** – Prindërit (dhe mësuesit dhe shoqëria e përgjithshme) mund të shikojnë punën e fëmijëve si pjesë të edukimit të fëmijës, veçanërisht në rajone ku arsimit nuk përkthehet në përfitime ekonomike për të rinjtë. Prindërit gjithashtu mund të mbështesin punën e fëmijëve si mënyrë për t'i mbajtur fëmijët e tyre të sigurt, në rajone ku disa fëmijë diskriminohen dhe i nënshtrohen dhunës në shkollë (për shembull vajzat në Azinë Jugore dhe fëmijët Romë në Evropë).
- **Mjedisi i çrregulluar familjar** – Familjet me një prind, sëmundja ose paaftësia e fituesit të bukës, varësia e tij ndaj alkoolit ose drogës, mungesa e aftësive të prindërve, abuzimi dhe dhuna, e vënë fëmijën në rrezik më të madh për përfshirje në punën e fëmijëve, qoftë

⁶ Asnjë prag orësh nuk është caktuar për punët shtëpiake për moshat 15-17 vjeç.

për shkak se fëmija do të detyrohet që të punojë nga prindërit e tij, ose sepse ai do të largohet nga shtëpia për të jetuar jetën e tij (p.sh.: fëmijët në rrugë).

- **Mungesa e qasjes në arsim** – kur kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të arsimit (përfshirë koston e rrobave, librave, materialeve) janë shumë të larta që prindërit t`u lejojnë fëmijëve t`i ndjekin mësimet dhe/ose kur shkollat janë gjeografikisht të largëta.
- **Diskriminimi** – disa minoritete, si romët në Evropë, mund të kenë qasje më të vogël në arsim ose tregun e punës dhe mund të pritët që ato të kryejnë detyra specifike përderisa janë ende fëmijë. Një tjetër bazë e përbashkët për diskriminimin është gjinia. Ndarja me bazë gjinore e punës mund t`i detyrojë gratë dhe burrat t`i kufizojnë perspektivat e punës së tyre në një varg të caktuar që nuk ka nevojë për arsim por praktika “në punë” që në moshë të re. Vajzat gjithashtu mund të detyrohen të qëndrojnë në shtëpi dhe të kryejnë detyra që nuk kompensohen.
- **Kërkesa: kosto më të ulëta dhe aftësi gjoja të pazëvendësueshme** – janë dy arsye kryesore që punëdhënësit të punësojnë fëmijë. Fëmijët punojnë për paga më të lira, janë më të lehtë për t`u manipuluar dhe mund të kryejnë veprimtari që të rriturit nuk mund t`i bëjnë me të njëjtën kosto. Fëmijët gjithashtu nuk kanë dijeni për të drejtat e tyre dhe ka më pak të ngjarë të ankohen ose të revoltohen.
- **Kërkesa: Kërkesat e klientit** – Për një lloj shfrytëzimi të caktuar (si shfrytëzimi seksual i fëmijëve), klientët mund të preferojnë t`i shfrytëzojnë fëmijët në vend të të rriturve.
- **Përhapja e sektorit informal dhe mungesa e zbatimit të ligjit** – Mungesa e kontratave dhe shoqatave/negocimit kolektiv në sektorin informal e vështirësojnë mbrojtjen e fëmijëve nga kushtet abuzive të punës dhe identifikimin e fëmijëve në punë. Një nga anët negative të globalizimit është se ka kontribuar në zgjerimin e marrëveshjeve nën-kontraktuese, ku shfrytëzohet puna e fëmijëve.
- **Përkeqësimi i sundimit të ligjit** ka lejuar që ekonomia në hije të rritet dhe korrupsioni të pushtojë shumë aspekte të jetës së njerëzve. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në (a) incidencën e formave më të këqija të punës së fëmijëve në lidhje me aktivitetet kriminale (veprimtari të paligjshme, trafikim dhe prostitucion - kur kriminalizohet), dhe (b) zbatimin e ligjeve dhe politikave të lidhura me punën e fëmijëve.
- **Ekziston edhe një «vakum i vlerës» i përkohshëm**, në të cilin presionet konkurruese nga konsumatorizmi perëndimor kundrejt traditave dhe privimi ekstrem personal ka (a) shkatërruar bazën e vlerës së familjes dhe komunitetit dhe (b) për rrjedhojë ka rritur cenueshmërinë e fëmijëve. Për shkak të mungesës së mbikëqyrjes dhe kujdesit të duhur, rrugët bëhen zona kryesore për socializimin e fëmijëve.

1.3 Pasojat e punës së fëmijëve

Puna e fëmijëve ndikon në zhvillimin e fëmijëve sa i përket shëndetit, arsimit, moralit dhe mirëqenies psikologjike. Ajo gjithashtu prek familjen dhe shoqërinë.

i. Ndikimi te fëmija

Më poshtë janë shkallët deri në të cilat fëmijët ndikohen nga format e ndryshme të punës nga perspektiva shëndetësore dhe e sigurisë:⁷

- Lëndimet fizike dhe gjymtimet shkaktohen nga makineri të mirëmbajtura dobët në ferma dhe fabrika, aksidente me hanxhar në plantacione dhe një numër rreziqesh që hasen në industri të tilla si minierat, përpunimi i drurit dhe prodhimi.
- Helmimet nga pesticidet janë një nga vrasësit më të mëdhenj të punëtorëve fëmijë në sektorin e bujqësisë, në të gjithë botën.
- Mangësia e rritjes është e përhapur te fëmijët që punojnë, të cilët kanë tendencë të jenë më të shkurtër dhe me më pak peshë se fëmijët e tjerë; këto mangësi ndikojnë edhe në jetën e tyre si të rritur.
- Problemet shëndetësore afatgjata, të tilla si sëmundjet e frymëmarrjes, asbestoza dhe një sërë kanceresh, janë të zakonshme në vendet ku fëmijët detyrohen të punojnë me kimikate të rrezikshme.
- HIV/AIDS dhe sëmundje të tjera seksualisht të transmetueshme janë të përhapura midis një milion fëmijëve të trafikuar çdo vit; shtatzënia, varësia nga droga dhe sëmundjet mendore janë gjithashtu të zakonshme në mesin e fëmijëve të përdorur për prostitucion.
- Rraskapitja dhe kequshqyerja janë rezultat i fëmijëve të pazhvilluar që kryejnë punë të rëndë fizike, duke punuar orë të gjata në kushte të padurueshme dhe duke mos fituar mjaftueshëm për të ushqyer veten e tyre në mënyrë adekuatë.

Puna e fëmijëve mund të ketë një ndikim negativ në zhvillimin mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të fëmijës për shkak të:

- paaftësisë së fëmijëve në punë për të ndjekur shkollën normalisht; qoftë sepse nuk i ndjekin mësimet ose sepse janë shumë të lodhur për t'u përqendruar në mësim, fëmijët në punë nuk ndjekin një arsimim normal.

⁷ Fondacioni ECLT, 2005, <http://www.eclt.org/about/overview.html>

- thyerjes së rrjeteve sociale (fëmijët që punojnë nuk kanë kohë për të parë miqtë e tyre) pasi mungesa e tyre në shkollë gjithashtu i pengon ata që të shoqërohen me bashkëmoshatarët e tyre.
- aktiviteteve jo-stimuluese, monotone që kanë ndikim negativ në krijimtarinë/fleksibilitetin e ardhshëm të fëmijëve; tregtia/aktivitetet që fëmijët në punë do të mësojnë nga «përvoja» do të jenë specifike dhe me aftësi të ulëta. Kjo nuk do të lejojë që fëmija të fitojë fleksibilitetin dhe aftësitë e nevojshme për të përfituar nga mundësitë në jetën e tij prej të rrituri.
- të gjitha llojeve të keqtrajtimit, përfshirë pakujdesinë, trajtimin jo-konsistent dhe të ashpër, abuzimin emocional dhe shtrëngimin;

Përshkrimi i hollësishëm i rreziqeve specifike dhe ndikimit të tyre të mundshëm te fëmijët në Kosovë, për secilin aktivitet të rrezikshëm, jepet në UA 05/2013.

II. Ndikimi në familje

Në planin afatshkurtër, puna e fëmijëve rrit të ardhurat e familjeve dhe shanset e mbijetesës, por në planin afatgjatë, puna e fëmijëve përjetëson varfërinë familjare përmes kapitalit më të ulët njerëzor, pasi puna e fëmijëve nuk çon në zhvillimin e aftësive.

III. Ndikimi në shoqëri

Puna e fëmijëve mund të ngadalësojë rritjen dhe zhvillimin shoqëror përmes zvogëlimit të akumulimit të kapitalit njerëzor. Nëse fëmijët në fakt zëvendësojnë punëtorët e rritur duke krijuar papunësi të rriturit dhe/ose ulje të pagave të rriturve mbetet një pyetje e hapur; por në atë masë që fëmijët konkurrojnë me të rritur të pakualifikuar për punë të njëjta, fëmijët në punë ndikojnë në punësimin e të rriturve ose në pagat e të rriturve në varësi të strukturës së tregut të punës.⁸

8 ELDIS, 2005, <http://www.eldis.org/static/DOC12028.htm>

PJESA 2

KORNIZA LIGJORE
DHE INSTITUCIONALE
PËR MBROJTJEN E
FËMIJËVE NË KOSOVË

2.1 Korniza ligjore për mbrojtjen e fëmijëve

Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijës përfshin kornizën ligjore, strukturat, masat dhe veprimet të cilat koordinojnë ndërhyrjet për të parandaluar, identifikuar në kohë, vlerësuar dhe ndërhyrë përmes një plani veprimi multidisiplinar dhe që synon mbrojtjen e fëmijës, si dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës (Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës).

Një njohuri e plotë e ligjeve dhe detyrimeve që u përcaktojnë institucioneve publike, duke përkrahur administrimin e shërbimeve dhe kompetencën ligjore të atyre institucioneve në adresimin e punës së fëmijëve është thelbësore, nëse Qendrat për Punë Sociale (QPS) dhe Zyrtarët e Shërbimeve Sociale janë për të mbështetur interesat e **fëmijëve në punë**. Korniza ligjore që rregullon mbrojtjen e fëmijëve nga puna e fëmijëve përkrahur në kutinë më poshtë.

Kutia 1: Korniza ligjore për mbrojtjen e fëmijëve nga puna e fëmijëve

Ligjet	Aspekte specifike të rreguluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës</p>	<p>Ky ligj ka për synim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1 mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi; 1.2 mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës; 1.3 garantimin dhe sigurimin e përgjegjësive të prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të fëmijës; 1.4 përcaktimin e parimeve bazë ku mbështeten politikat kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, mekanizmat efikase dhe autoritetet përgjegjëse në nivel qendror e lokal, si dhe kompetencat e tyre për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës; 1.5 garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik; 1.6 marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin gradual të aftësive të fëmijës, bazuar në interesin më të mirë të tij; 1.7 marrjen e masave për të siguruar jetesën, mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës; 1.8 sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatave për mbrojtjen e fëmijës; 1.9 përcaktimin e mekanizmave efektive, funksionimin e institucioneve mandatore dhe marrjen e masave konkrete për parandalim, reagim dhe mbrojtje të fëmijës; 1.10 ngritjen e sistemit të integruar e funksional të mbrojtjes së fëmijës, për parandalimin dhe përgjigjen efikase ndaj të gjitha formave të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit.

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 2004/32 Ligji për familjen i Kosovës dhe Ligji nr. 06/L-077 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës</p>	<p><i>Neni 125. Parimi për mbrojtjen e fëmijëve</i></p> <p>(5) Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik, eksploatimit të fëmijëve, trafikimit dhe eksploatimit seksual dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rrezik ose që cenon edukimin ose dëmton shëndetin e tyre.</p> <p>(6) Fëmijët duhet të mbrohen nga keqtrajtimi dhe dhunimi seksual.</p> <p>(7) Fëmijët duhet mbrojtur nga përdorimi i paligjshëm i drogave dhe substancave psikotrope dhe nuk duhet lejuar që fëmijët të përdoren për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve.</p> <p><i>Neni 128. Parimet për përgjegjësinë prindërore</i></p> <p>(2) Fëmija është nën përgjegjësi prindërore deri në moshën madhore.</p> <p>(3) Prindërit janë të detyruar të sigurojnë në çdo kohë që parimet e përcaktuara në nenin 125 të këtij Ligji përdoren për mbrojtjen e fëmijëve të tyre të mitur.</p> <p>(4) Përgjegjësia prindërore përfshin të drejtat dhe detyrat që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë.</p> <p>(5) Duke i zbatuar këto parime, prindërit duhet t'i kenë në konsiderim aftësitë, prirjet dhe dëshirat e fëmijëve të tyre.</p> <p><i>Neni 129. Kontributi personal dhe shfrytëzimi i shërbimeve publike</i></p> <p>Për të realizuar kujdesin prindëror dhe për të zbatuar parimet e nenit 128 të këtij Ligji prindërit janë të detyruar personalisht të japin kontributin e tyre si dhe të shfrytëzojnë shërbimet e institucioneve shoqërore nëse është e nevojshme.</p> <p><i>Neni 147. Masat urgjente të Organit të Kujdestarisë</i></p> <p>(1) Nëse Organi i Kujdestarisë mëson për rrezikun ekzistues për fëmijën për shkak të abuzimit të të drejtës prindërore ose çfarëdo rreziku për fëmijën nga neglizhenca serioze e detyrave prindërore, është i detyruar që urgjentisht të ndërmerr masa për mbrojtjen e personalitetit, të drejtave dhe interesave të fëmijës.</p>

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 2004/32 Ligji për familjen i Kosovës dhe Ligji nr. 06/L-077 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës</p>	<p><i>Neni 148. Marrja e fëmijës nga kujdesi i prindërve</i></p> <ol style="list-style-type: none"> (1) Fëmija nuk do të largohet nga kujdesi i prindit/prindërve të tij/saj ose të kujdestarit të tij ligjor pa lejen e tyre apo pa urdhër të gjykatës. (2) Përjashtimisht, kur organi i kujdestarisë ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, organi i kujdestarisë mund të hyjë në cilin do vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai/ajo do të ketë përkujdesje për një periudhë që nuk kalon 72 orë. (3) Para se të skadojë afati prej 72 orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse e kërkojnë rrethanat, gjykata mund të jep urdhër për vlerësim për një periudhë 21 ditësh, për të mundësuar hetime të më-tutjeshme dhe vlerësime, deri në të cilën kohë çështja duhet të paraqet në gjykatë për shqyrtim të mëtejshëm. (4) Me këtë marrje të fëmijës nuk pushojnë të drejtat e tjera që u takojnë prindërve, as detyrat e tyre ndaj fëmijës. <p><i>Neni 149. Privimi nga Kujdesi</i></p> <ol style="list-style-type: none"> (1) Prindërit të cilët e keqpërdorin ushtrimin e të drejtës prindërore ose në mënyrë serioze e neglizhojnë ushtrimin e të drejtës prindërore, privohen nga Kujdesi. (2) Prindi mund të privohet nga kujdesi për të gjithë fëmijët, e nëse këtë gjë e kërkojnë rrethanat e posaçme, ata privohen nga kujdesi vetëm ndaj njërit fëmijë. (3) Vendimin mbi privimin e prindërve nga kujdesi prindëror e merr gjykata kompetente në procedurë jashtë kontestimore pasi të ketë marrë mendimin nga Organi i Kujdestarisë dhe pasi të ketë hetuar të gjitha rrethanat relevante lidhur me rastin individual.

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare</p>	<p><i>Ky Ligj përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë. Ndër të tjera, Ligji përcakton rolin e palëve kryesore të interesit në nivelin qendror dhe komunal për ofrimin e shërbimeve familjare dhe sociale (përshkruar në seksionin tjetër).</i></p> <p><i>Shërbimet për fëmijë dhe familje dhe mbrojtja e fëmijëve rregullohen si më poshtë:</i></p> <p><i>Neni 9 Shërbimet për Fëmijë dhe Familje</i></p> <p>9.1. Në të gjitha çështjet lidhur me ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe familje, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata e parë dhe më e rëndësishme.</p> <p>9.2. Në bashkëpunim me familjet, komunitetin, organizatat joqeveritare dhe organet e tjera të caktuara me ligj, komuna ofrojnë përkujdesje sociale, këshillim social dhe, në rrethana të jashtëzakonshme, asistencë materiale për fëmijët dhe familjet e tyre të cilët janë në nevojë dhe jetojnë në territorin e saj, duke u mbështetur në vlerësimin e nevojave të tyre për këto shërbime dhe aftësinë e komunës që t'i plotësojë ato mënyrë të arsyeshme.</p> <p>9.3. Qendra për punë sociale ofron përkujdesje sociale dhe/ose këshillim në rrethanat kur një fëmijë është në nevojë për shërbime sociale dhe familjare.</p> <p>9.4. Qendra për punë sociale mban një regjistër të familjeve dhe të fëmijëve në nevojë të cilët jetojnë në territorin e saj, nuk gëzojnë përkrahje nga familja ose komuniteti ose kanë vështirësi që të përkujdesen për fëmijët e tyre, ose kur fëmija është në rrezik ngase lihet pas dore, shfrytëzohet, abuzohet ose në çfarëdo forme tjetër dëmtohet. Qendra për punë sociale cakton vizita të rregullta për ato familje në nevojë që gjenden në regjistrin për shërbime sociale dhe familjare nga një person përgjegjës, në mënyrë që të krijohet siguria dhe mirëqenia e fëmijës dhe t'i sigurohet familjes çfarëdo shërbimi që konsiderohet i arsyeshëm.</p> <p>9.5. Në përmbushjen e detyrave të veta sipas Kodit për të miturit, qendra e punës sociale në rolin e organit të kujdestarisë siguron që shërbimet e ofruara në bazë të mandatit që ka janë në përputhje me obligimet që përmban Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.</p> <p>9.6. Në rastin kur gjykata njofton QPS-në për procedurat ndaj fëmijës dhe ai fëmijë apo familja e tij i janë të njohura, QPS-ja ka për detyrë t'i ofrojë gjykatës çfarëdo informate apo këshille me rëndësi për menaxhimin e duhur të rastit.</p>

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare</p>	<p><i>Neni 10. Mbrojtja e fëmijëve</i></p> <p>10.1. Interesat më të mira të fëmijës zakonisht përmbushen kur nevojat e zhvillimit të tyre fizik dhe psikologjik plotësohen brenda kontekstit të familjes natyrore të tij. Të gjitha entitetet duhet të bëjnë çdo përpjekje të promovojnë mirëqenien e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike përmes ofrimit të përkujdesjes, mbrojtjes dhe këshillimit social dhe, në raste të jashtëzakonshme, asistencës materiale.</p> <p>10.2. Vetëm në rrethanat kur ka arsye për të dyshuar se një fëmijë është duke pësuar dëm serioz në shëndetin e tij fizik ose mendor, ose është në rrezik për diçka të tillë brenda familjes së tij, mund të merret në konsideratë heqja e tij nga përkujdesja e prindit ose prindërve ose përkujdesësit tjetër të tij.</p> <p>10.3. Me përjashtim të rasteve të masave urgjente afatshkurtra, një fëmijë nuk do të hiqet nga kujdesi i prindit, prindërve ose kujdestarit ligjor, pa lejen e tyre ose pa urdhër të gjykatës.</p> <p>10.4. Nëse një nëpunës i shërbimeve sociale ka arsye të besojë se ekziston rrezik serioz imediat për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e një fëmije, ai profesionist mundet, me kompetencat që ka, të hyjë në çdo ndërtesë dhe të vendosë fëmijën në një vend të sigurt ku do t'i ofrohet përkujdesja për një periudhë të caktuar jo më të gjatë se shtatëdhjetë e dy (72) orë.</p> <p>10.5. Para skadimit të shtatëdhjetë e dy (72) orëve, nëse kujdestari nuk e siguron pëlqimin e prindit/prindërve apo kujdestarit ligjor, çështja duhet të paraqitet në gjykatën kompetente e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse kërkojnë rrethanat, gjykata mund t'i japë urdhër për vlerësim të kujdestarit ligjor brenda një periudhe prej njëzet e një (21) ditësh, për t'i lejuar hetimet e mëtejshme.</p> <p>10.6. Çdo pjesëtar i profesionit të mësuesisë, infermierisë, mjekësisë, stomatologjisë, psikologjisë ose i policisë apo profesionist tjetër që ka për detyrë përkujdesjen për fëmijët, i cili dyshon ose ka dëshmi se një fëmijë vuan nga abuzimi fizik, seksual ose psikologjik nga ana e prindit ose përkujdesësit të tij është i obliguar me këtë ligj që t'ia raportojë çështjen drejtorit të qendrës përkatëse të punës sociale. Pamundësia e grupeve të cekura më lart për të vepruar asisoj mund të sanksionohet sipas ligjit në fuqi. Dështimi për ta bërë këtë nga ana e ndonjë prej grupeve të lartpërmendura, bën që ata të ndiqen penalisht.</p>

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe Ligji nr. 04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare</p>	<p>10.7. Kur një qendër për punë sociale bëhet me dije se ka arsye për të dyshuar se një fëmijë që jeton ose gjendet në territorin e saj, është i braktisur ose bonjak ose duke vuajtur ose i kërcënuar nga çfarëdo forme e dhunës fizike apo mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore ose trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, duke përfshirë abuzimin seksual, përderisa është nën përkujdesjen e prindit(ve) ose çfarëdo personi tjetër që kujdeset për fëmijën, qendra për punë sociale duhet të marrë çdo hap të nevojshëm për ruajtjen e sigurisë së fëmijës, të raportojë pa vonesë çështjen tek Departamenti i Mirëqenies Sociale dhe të zhvillojë vlerësim gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës për mbrojtje.</p> <p>10.8. Në rrethanat kur ka arsye për të dyshuar se fëmija është jashtë kontrollit të prindërve të tij ose personave që kanë përgjegjësinë për t'u kujdesur për të, në përmasat sa sjellja e tyre dhe mënyra e tyre e jetesës paraqet rrezik serioz për mirëqenien, shëndetin dhe sigurinë e tyre dhe të tjerëve, atëherë kujdestari i qendrës për punë sociale duhet të bëjë një vlerësim gjithëpërfshirës profesional për nevojat e fëmijës për shërbime sociale dhe familjare</p> <p>10.9. Është detyrë e çdo profesionisti që ka pasur kontakt me fëmijën, i cili i nënshtrohet vlerësimit gjithëpërfshirës profesional nga ana e një Qendër për Punë Sociale që të bashkëpunojë dhe të asistojë gjatë vlerësimit kur është e mundur</p> <p>10.10. Kur dyshohet në abuzimin e ndonjë fëmije, organet për zbatimin e ligjit kanë për detyrë që t'i ndihmojnë qendrës për punë sociale në vlerësimin e saj gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës për shërbime sociale dhe familjare dhe të zhvillojë hetimet e veta kriminale nëse rrethanat e arsyetojnë këtë</p> <p>10.11. Pas përfundimit të vlerësimit gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës për shërbime sociale dhe familjare, QPS i dërgojë pa vonesë brenda njëzet e katër (24) orëve njoftimin drejtorisë përkatëse të komunës.</p> <p>Nëse kujdestari i QPS-së konsideron se ka arsye për të kërkuar masa mbrojtëse, ka për detyrë t'ia referojë çështjen gjykatës, në mënyrë që gjykata të nxjerrë një vendim në formën e mbrojtjes.</p>

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 2003/15 për Skemën e Ndhimës Sociale në Kosovë dhe Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale</p>	<p>Ky ligj përcakton skemën e ndihmës sociale të Kosovës me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së familjeve të rrezikuara në aspektin social. Rregullon sigurimin e ndihmës financiare për familjet e pranueshme në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe brenda burimeve të alokuara për këtë qëllim.</p> <p><i>Neni 4 (Kriteret jo-financiare për ndihmë sociale) përcakton pranueshmërinë e familjeve për ndihmë financiare:</i></p> <p>4.1. Për të realizuar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive të përcaktuara me këtë ligj;</p> <p>4.2. megjithatë, përdorues të ndihmës sociale mund të jenë edhe shtetas të huaj, të cilët:</p> <ul style="list-style-type: none"> a). kanë leje të qëndrimit në Kosovë; b). personat në cilësinë e azilkërkuës; c). personat në cilësinë e refugjati; dhe d). persona që gëzojnë mbrojtje të përkohshme ose plotësuese <p>4.4. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja, në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2 pikën 2.7 të ligjit në fuqi, dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.</p> <p>4.5 Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë dhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> a). me të paktën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç; apo b). që kanë në përkujdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç. <p>Të gjithë anëtarët e familjes brenda Kategorisë II duhet të jenë ose të varur, ose të regjistruhen si të papunë në Zyrat e Punësimit të Ministrisë.</p>

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
	<p>Ky ligj rregullon arsimin parauniversitar dhe aftësimin nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele.</p> <p>Parimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar përshkruhen në nenin 3, përfshirë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim. 2. Arsimi parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj. 3. Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social. 4. Gjatë planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore. <p>Mosha për shkollim të detyruar rregullohet sipas <i>nenit 9: Organizimi i arsimit parauniversitar</i>:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shkollimi i detyruar fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën gjashtë (6) vjeçare që është mosha minimale për shkollimin e detyruar dhe përfundon në fund të nivelit 2 të ISCED-it. 2. Shkollimi i detyruar ofrohet falas. <p><i>Sa i përket dispozitave specifike për arsimin dhe aftësimin e të rriturve (neni 12)</i></p> <p>Dispozitat specifike për arsimin dhe aftësimin e të rriturve</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Qëllimi i arsimit dhe i aftësimit të rriturve është zhvillimi i shkathtësive, njohurive dhe parimeve të duhura të rriturit si pjesë e kornizës së të mësuarit gjatë gjithë jetës. 2. Të rriturit mund të arsimohen ose aftësohen në institucionet e licencuara private, publike dhe të partneritetit të niveleve 3 dhe 4 të ISCED-it, sipas dispozitave të këtij ligji.

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar</p>	<p><i>Vijueshmëria në shkollë rregullohet nga neni 15:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vijimi i shkollimit të detyruar nga ana e nxënësit është një përgjegjësi kryesore e prindit. 2. Prindi i fëmijës së moshës së shkollimit të detyruar bën shkelje të ligjit, nëse: <ol style="list-style-type: none"> 2.1. nuk e regjistron fëmijën në shkollë publike, institucion aftësimi, shkollë speciale ose shkollë private të licencuar dhe të përshtatshme për moshën e fëmijës dhe për nivelin e mësimi, ose nuk bën aranzhime alternative për arsimimin e fëmijës me miratim nga Ministria sipas nenit 47 të këtij ligji, ose 2.2. pa shkak të arsyeshëm, si është sëmundja apo ndonjë shkak tjetër i pashmangshëm, nuk i siguron fëmijës vijim të rregullt në institucionin arsimor në kohën e përcaktuar nga këshilli drejtues për fillimin e mësimi 4. Nëse nxënësi pa ndonjë arsye nuk regjistrohet, nuk vijon shkollimin ose e ndërprente shkollimin e detyruar, prindërit e tij dënohen për kundërvajtje nëse mungesa është rezultat i veprimit të paramenduar ose i neglizhencës së prindërve. Në raste të tilla, komuna e njofton Ministrinë me shkrim. 5. Për të promovuar vijimin ose zvogëluar braktisjen e shkollës, komuna organizon transport të sigurt dhe efikas për nxënësit në shkollimin e detyruar. Komuna mund të kërkojë pagese por edhe mund ta bëjë falas transportin shkollor, për <ol style="list-style-type: none"> 5.1. nxënësit që jetojnë në zonën e mbulimit, por që janë brenda distancës prej katër (4) kilometra nga shkolla, përveç nxënësve me aftësi të kufizuara; dhe 5.2. nxënësit që jetojnë jashtë zonës së mbulimit;
<p>Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komuna</p>	<p>Ky ligj rregullon organizimin e institucioneve arsimore publike dhe ofrimin e arsimit publik në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë në komuna.</p>

Ligjet	Aspekte specifike të rreguluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 03/L -212 i Punës</p>	<p>Ligji i Punës rregullon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p><i>Neni 6</i> ndalon punën e detyruar ose të dhunshme;</p> <p><i>Neni 7 Kushtet dhe kriteret për krijimin e marrëdhënies së punës rregullon moshën minimale të punës:</i></p> <p>3. Asnjë punëdhënës nuk mund të lidhë një kontratë pune me një person nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.</p> <p><i>Neni 20 Përcaktimi i orarit të punës</i>, për punonjësit nën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, kufizon orarin e plotë të punës në tridhjetë (30) orë në javë;</p> <p><i>Neni 26</i> ndalon zgjatjen e orarit të punës për punonjësit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç;</p> <p><i>Neni 27</i> ndalon ndërrimet e natës për punonjësit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç;</p> <p><i>Neni 31</i> përcakton një pushim javor për një periudhë prej të paktën tridhjetë e gjashtë (36) orë të vazhdueshme për punonjësit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç;</p> <p><i>Neni 45 Mbrojtja e të rinjve</i> përcakton masa specifike mbrojtëse për punonjësit nën tetëmbëdhjetë vjeç:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. I punësuari nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punojë në punët të cilat për nga natyra apo rrethanat nën të cilat kryhen, mund të dëmtojnë shëndetin, sigurinë apo moralin e tij. 2. Punëdhënësi është i obliguar që të adoptojë masat e nevojshme për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të të rinjve, duke specifikuar rreziqet në procesin e punës. 3. Punëdhënësi duhet t'i zbatojnë masat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë për vendet e punës së të rinjve. 4. Për mbrojtjen e plotë të të rinjve në punë, punëdhënësi duhet ta bëjë vlerësimin paraprak të rrezikshmërisë për vende të punës, para se i riu t'ia fillojë punës. 5. I punësuari nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç nuk mund të punojë në punët e rrezikshme, si në vijim: <ol style="list-style-type: none"> 5.1. në nëntokë, nën ujë, në lartësi të rrezikshme apo në vende të mbyllura, 5.2. me makineri të rrezikshme, në pajisjet dhe veglat, të cilat duhen shfrytëzuar, dhe në transportimin e ngarkesave të rënda; 5.3. në mjedis jo të shëndoshë, i cili për shembull i ekspozon të rinjtë në substancat e rrezikshme, faktorëve ose proceseve, temperaturave, zhurmave dhe dridhjeve që dëmtojnë shëndetin e tyre; 5.4. nën kushte posaçërisht të vështira siç është puna me orar të gjatë, apo në rrethana të caktuara gjatë natës, puna në mjedis të mbyllur. 6. Dispozitat që zbatohen për listën e llojeve të punëve të rrezikshme, duhet të shqyrtohen çdo vit, nga organi përkatës i përfaqësuesit e tyre të cilët janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ministritë e tjera përkatëse të Qeverisë, organizatat e punëdhënësve dhe organizatat të të punësuarve (sindikatat).

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 04 / L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë</p>	<p>Ky ligj përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve.</p>
<p>Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal</p>	<p>Ndalimi i rekrutimit ushtarak nga grupet e armatosura jo-shtetërore rregullohet me nenin 149 Rekrutimi ose regjistrimi i fëmijëve në konfliktin e armatosur;</p> <p>Ndalimi i skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, siç janë shitja dhe trafikimi i fëmijëve, skllavëria e borxhit dhe skllavëria dhe puna e detyruar ose e dhunshme rregullohet me nenet 163 dhe 165 Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar;</p> <p>Ndalimi i shfrytëzimit seksual komercial të fëmijëve rregullohet me nenin 232 Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi dhe nenin 234 Mundësimi ose detyrimi në prostitucion.</p> <p>Ndalimi i përdorimit të fëmijëve në prodhimin dhe trafikimin e drogës rregullohet me nenet 271-273.</p>

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Kodi nr. 06/L -006 Kodi i Drejtësisë për të Mitur</p>	<p>Ky Kod rregullon veprimin ndaj të miturit si kryes i veprës penale, fëmijët e përfshirë dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë, organeve të cilat zbatojnë procedurë penale dhe ekzekutimin e masave dhe dënimeve ndaj kryesit të mitur të veprës penale, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktima dhe të dëmtuar nga vepra penale.</p> <p>Parimet themelore të Kodit përcaktohen në nenin 4, përfshirë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Interesi më i mirë duhet të jetë konsiderata mbizotëruese gjatë gjithë procedurës dhe veprimeve që ndërmerren ndaj fëmijës dhe të miturit. 2. Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale. 3. Kryerësve të mitur u shqiptohen masat e diversitetit dhe masat edukative, sipas nevojës, duke i dhënë përparësi masave dhe sanksioneve alternative në relacion me sanksionet penale. 4. Privimi nga liria shqiptohet vetëm si mjet i fundit dhe do të kufizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Gjatë kohës së privimit nga liria, i shqiptuar si dënim, kryesit të mitur i ofrohet edukim, ndihmë psikologjike, sipas nevojës, edhe ndihmë mjekësore, për ta lehtësuar rehabilitimin e tij. 5. Fëmijës që merr pjesë në procedurë penale i ofrohet mundësia që të shprehet lirisht. 6. Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj. 7. Çdo i mitur i privuar lirie ka të drejtë në ndihmë të menjëhershme ligjore dhe ndihmë tjetër adekuate, si dhe të drejtën për të kundërshtuar ligjshmërinë e privimit të tij nga liria pranë një gjykate të pavarur dhe të paanshme, si dhe në procedurë të menjëhershme. 8. Për t'iu shmangur lëndimit për shkak të publicitetit të tepruar ose etiketimeve, e drejta e fëmijës për privatësi respektohet në të gjitha fazat. Në parim, nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur apo riviktimizimin e viktimës. 9. Procedura ndaj të miturit dhe procedurat e të cilën i mituri është i dëmtuar me veprë penale është urgjente. Organet të cilat marrin pjesë në procedurë ndaj të miturit si dhe organet tjera dhe institucionet nga të cilat kërkohen njoftime, raporte ose mendime, janë të detyruar të veprojnë në mënyrë urgjente. 10. Mosveprimi sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin 9 të këtij neni, si dhe mos-respektimi i afateve të parapara me këtë kod, mund të konsiderohet shkelje disiplinore, në pajtim me dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi. 11. Procedura ndaj fëmijëve dhe të miturve duhet të zhvillohet dhe zbatohet në pajtim me konceptin e qasjes miqësore.

Ligjet	Aspekte specifike të rregulluara në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga puna
<p>Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit</p>	<p>Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave juridike përmes të cilave, autoriteteve kompetente vendore iu jepen të drejta, obligime dhe përgjegjësi, për:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1. parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij; 1.2. mbrojtjen e viktimave të trafikuar, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko- sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifikohen si të trafikuar, pavarësisht gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësisë fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religionit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale racës, pronës, lindjes ose statuseve tjera, përmes një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut, në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe standardeve. <p><i>Neni 34 Dispozita të përgjithshme lidhur me ndihmën dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimave të trafikimit me njerëz:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fëmijët që janë viktimë e trafikimit përfitojnë ndihmë dhe mbrojtje. Interesat më të mira të fëmijës duhet të merret në konsideratë gjatë zbatimit të legjislacionit. 2. Autoritetet për kujdesin social, shëndetësor edukim, organizatat joqeveritare, institucionet tjera, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, pa vonesë, kontaktojnë autoritetet për zbatimin e ligjit kur kanë njohuri ose kur dyshojnë se një fëmijë është shfrytëzuar apo trafikuar, apo i është ekspozuar rrezikut të shfrytëzimit apo trafikimit. <p><i>Neni 35 Parimet e posaçme të luftimit të trafikimit me fëmijë</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përveç parimeve themelore të përcaktuara në nenin 4, parimet e posaçme të përcaktuara më poshtë do të merren parasysh në aktivitetin e parandalimit dhe luftimit të trafikimit me fëmijë dhe mbrojtjen apo ndihmën e fëmijëve që janë viktimë e trafikimit të tillë: <ol style="list-style-type: none"> 1.1. respektimi strikt i të drejtave të fëmijës të përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe në Kodin i Drejtësisë për të Mitur në Kosovë si dhe ndonjë legjislacionin tjetër përkatës; 1.2. ndërmarrja e masave për mbrojtje dhe ndihmë të posaçme të fëmijëve që janë viktimë e trafikimit me njerëz; 1.3. Kurdo që një fëmijë viktimë e trafikimit është i aftë të formojë pikëpamjet e tij apo të saj, duke i dhënë rëndësinë e duhur mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën e tij / saj dhe pjekurinë e tij / saj dhe interesat më të mira të tij/saj; 1.4. informimi i fëmijës që është viktimë e trafikimit me njerëz në një mënyrë të përshtatshme për fëmijë lidhur me gjendjen dhe të drejtat e tij/saj, masat e mbrojtjes dhe ndihmës, shërbimet në dispozicion, procedurat e riatdhesimit, dhe procesin për bashkim familjar; 1.5. sigurimi që identiteti, si dhe çfarëdo detajesh që mund të bëjnë të mundur identifikimin e fëmijës viktimë të trafikimit, të mos bëhen publike në asnjë rrethanë. <p>Konsiderata specifike për riatdhesimin e fëmijëve që janë viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe për ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes për fëmijët viktimave të trafikimit me qenie njerëzore përcaktohen në nenet 37 dhe 38.</p>

2.2 Përgjegjësitë ligjore të palëve kryesore të interesit

Korniza institucionale për mbrojtjen e fëmijëve

Institucionet e nivelit qendror janë kryesisht përgjegjëse për të hartuar dhe zbatuar politika, për të vendosur standarde dhe për të siguruar cilësi të programeve për mbështetjen e fëmijëve dhe kujdestarëve të tyre, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve, parandalimin e kërcënimeve për jetën e tyre, dhunën, neglizhencën, abuzimin, keqtrajtimin, braktisjen dhe shfrytëzimin. Përgjegjësia ligjore për zbatimin e politikave dhe standardeve për mbrojtjen e fëmijëve përqendrohet në institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe ofrimin e shërbimeve publike. Kështu më poshtë jep një listë të agjencive kryesore të zbatimit të ligjit dhe ofruesve të shërbimeve, përfshirë përshkrimin e rolit të tyre në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve.

Kutia 2. Përgjegjësitë ligjore të agjencive të zbatimit të ligjit, dhe ofruesve të shërbimeve publike dhe joqeveritare

Institucionet përgjegjëse	Detyrimet ligjore
<p>Inspektorati i Punës</p>	<p>Inspektorati i Punës është një Agjenci Ekzekutive e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, në mënyrën e përgjithshme të fushës së punësimit, duke përfshirë marrëdhëniet e punës, sigurinë në punë, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe mjedisit të punës.</p> <p>Funksionet e Inspektoratit të Punës përcaktohen me Ligjin nr. 2002/09 për Inspektoratin e Punës të Kosovës, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Sigurimin e zbatimit të ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtja në punë; (b) Sigurimin e informatave teknike dhe këshillave për punëdhënësit dhe punonjësit për çështjet më efektive të respektimit të dispozitave ligjore; (c) Njoftimin e Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale ose autoriteteve të tjera kompetente për çdo mangësi në ligjin në fuqi; (d) Furnizimin me informacion dhe këshilla për punëdhënësit dhe punonjësit, këshilla të cilat do të ishin në përputhje me ligjin dhe paralajmërimin e autoriteteve kompetente për çdo defekt ose abuzim që nuk mbulohet nga dispozitat ligjore ekzistuese; (e) Ofrimin e këshillave për çështje që lidhen me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punonjësve në një rast ose riorganizimin ose rristurimin e një ndërmarrje. <p>Për më tepër, sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (neni 49)</p> <p>3. Inspektorati i Punës është përgjegjës për monitorimin e punësimit të fëmijës për të garantuar mirësjelljen, sigurinë dhe kushtet e punës.</p>
<p>Policia</p>	<p>Autorizimet dhe detyrat e Policisë së Kosovës, organizimi i saj dhe çështje të tjera që lidhen me veprimtaritë dhe veprimet rregullohen me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë.</p> <p>Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë bazohet në ndërtimin e një partneriteti të shëndoshë dhe efikas me bashkësinë, shkëmbimin e dyanshëm të informatave në identifikimin e problemeve apo preokupimeve të bashkësisë në aspektin e sigurisë si dhe parandalimin e dukurive negative apo zgjidhjen e tyre bashkërisht me bashkësinë. Sektori policor nënkupton një pjesë të caktuar të një territori, brenda kufijve të një apo më shumë bashkësive lokale në territorin e një komune, në të cilin një numër i caktuar i zyrtarëve policorë kryejnë të gjitha veprimtaritë policore lidhur me ngritjen e bashkëpunimit, identifikimin e problemeve të bashkësisë dhe keqbërësve, parandalimin e dukurive negative në bashkësi, përmirësimin e sigurisë në trafikun rrugor dhe zgjidhjen e problemeve potenciale të cilat cenojnë sigurinë e përgjithshme të bashkësisë.</p>

Institucionet përgjegjëse	Detyrimet ligjore
Komuna	<p>Ligji për mbrojtjen e fëmijëve përcakton përgjegjësitë e mëposhtme të komunave (neni 14 Roli i Komunës)</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Secila komunë është përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtëse dhe ri-integruese për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të saj, sipas standardeve dhe politikave të përcaktuara nga Qeveria apo ministritë përkatëse. 2. Komunat duhet të marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të tyre. 3. Komunat përgatisin plane vjetore dhe financim përkatës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës. 4. Komunat janë të obliguara përmes drejtorive përkatëse, të caktojnë të paktën një zyrtar për mbrojtjen e fëmijës, i cili është i obliguar të bashkëpunojë, të shkëmbejë informata dhe të dhëna me Njësinë përkatëse për Qeverisje të Mirë. <p>Sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare (neni 6-Roli i Komunës)</p> <ol style="list-style-type: none"> 6.1. Secila komunë, përmes drejtoratit të saj përkatës, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas standardit të specifikuar nga Ministria. 6.3. Drejtoratet e komunave kryejnë shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre përmes aktiviteteve të qendrës për punë sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që merren me këtë veprimtari. 6.4. Drejtoratet marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre. Ato përgatisin plane vjetore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajnë shënime e statistika siç specifikohet nga Departamenti, duke qenë të detyruara që t'i paraqesin atij raportin për aktivitetet e tyre në fushë të shërbimeve sociale dhe familjare çdo vit, si dhe në çdo interval tjetër kohor, sipas kërkesës së Departamentit. Në mënyrë që të promovohet përfshirja e komunitetit, transparenca dhe llogaridhënia, çdo drejtorat publikon planin dhe raportin e tij vjetor.

Institucionet përgjegjëse	Detyrimet ligjore
Komuna	<p>6.5. Gjatë përgatitjes së planeve të tyre vjetore drejtoratet janë të obliguara që të konsultohen gjerësisht me shfrytëzuesit e shërbimeve sociale dhe familjare, përfaqësuesit e tyre, organizatat joqeveritare dhe grupet e tjera relevante të komunitetit dhe grupet profesionale në territorin e tyre në lidhje me zhvillimin, planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare.</p> <p>6.6. Çdo drejtorat siguron që qendra për punë sociale në territorin e vet të ketë resurse sipas standardeve të specifikuara nga Ministria. Kjo përfshin llojin dhe numrin e personelit profesional që duhet punësuar.</p> <p>6.7. Përveç sigurimit të resurseve për përmbushjen e përgjegjësive të caktuara për qendrat e punës sociale nga ky ligj dhe ligjet e tjera relevante, drejtoratet lejohen që nëpërmes QPS-ve dhe organizatave joqeveritare të sigurojnë ose mundësojnë ushtrimin e shërbimeve shtesë që vijojnë (a-g).</p> <p>6.8. Drejtorati bën përgatitje adekuate për t'u përgjigjur në rastet e shërbimeve urgjente sociale dhe familjare të cilat kërkohen jashtë orarit të rregullt të punës.</p> <p>6.9. Me lejen e Ministrisë, komunat mund të sigurojnë bashkërisht shërbime specialistike ose shërbime të tjera sociale dhe familjare në territoret e tyre.</p>

Institucionet përgjegjëse	Detyrimet ligjore
Qendra për Punë Sociale	<p>Sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare (neni 7-Roli i Qendrës për Punë Sociale)</p> <p>7.1. Secila komunë themelon një Qendër për Punë Sociale si institucion publik që do të ketë një ose më shumë degë (në tekstin e mëposhtëm: QPS) dhe personel të përbërë nga profesionistët me trajnime dhe kualifikime përkatëse - nëpunës të shërbimeve sociale sipas pikës 1.3 i. të këtij ligji. QPS është përgjegjëse për ushtrimin e kompetencave që ia jep ky ligj në emër të Ministrisë si dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në emër të Ministrisë.</p> <p>7.2. Qendra për punë sociale formon organin e kujdestarisë dhe kryen detyrat që kërkohen për këtë funksion siç janë përcaktuar me ligjet përkatëse të Kosovës.</p> <p>7.3. Drejtori i QPS-së zgjidhet nga komuna me anë të konkursit publik sipas Ligjit të shërbimit civil.</p> <p>7.4. Drejtori i QPS-së i jep llogari komunës për përdorimin në mënyrë të efektshme dhe të dobishme të resurseve të akorduara për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare.</p> <p>7.5. Drejtori i QPS-së i jep llogari Ministrisë për mbajtjen në nivel të standardeve të praktikës profesionale dhe ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisive të përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>7.6. QPS-ja është e obliguar të bëjë vlerësime profesionale për secilin individ ose familje që jeton ose gjendet në territorin e saj e që kërkon ndihmë prej saj ose në ndonjë mënyrë tjetër mësohet apo shihet se ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare.</p> <p>7.7. Nëse vlerësimi profesional tregon se një individ ose një familje ka nevojë për shërbime sociale dhe familjare, QPS-ja mundet, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat relevante, përfshirë edhe përkrahjen nga familja nëse ka familje dhe resurse të përshtatshme në dispozicion, të ofrojë shërbimet që i konsideron të përshtatshme.</p>
Shkolla	<p>Për sa i përket rolit të shkollave në parandalimin e braktisjes së shkollës si rezultat i punës së fëmijëve, Udhëzimi Administrativ nr. 19/2012 themelimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (TPRAN) përcakton parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe procedurat për krijimin dhe funksionimin e TPRAN. Këto ekipe janë funksionale në pothuajse të gjitha shkollat, përgjegjëse për të identifikuar fëmijët që nuk janë të regjistruar/rrezikojnë të braktisin/largohen nga shkolla, dhe, për të hartuar dhe zbatuar strategji të parandalimit të braktisjes në nivelin e shkollës.</p> <p>Arsimi joformal (orët plotësuese) për fëmijët që kanë braktisur shkollën për një periudhë tre vjeçare ose më shumë, sigurohet nga të paktën një shkollë në secilën komunë.</p>

Institucionet përgjegjëse	Detyrimet ligjore
<p>Qendra e Mjekësisë Familjare</p>	<p>Funksionimi i Qendrave të Mjekësisë Familjare rregullohet me Ligjin nr. 2004/4 për Shëndetësi të Kosovës, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe dëmtimeve; b) Edukimin shëndetësor; c) Imunizimin; d) Diagnostifikimin fillestar dhe kujdesin shëndetësor bazë, përfshirë operacione të vogla; e) Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit themelor shëndetësor të dhëmbëve; f) Kujdesin shëndetësor mendor të bazuar në komunitet; g) Rehabilitimin e bazuar në komunitet; h) Sigurimin e ujit dhe ushqimit cilësor. <p>Ekipi i mjekësisë familjare përbëhet nga punëtorët shëndetësorë si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Mjek i Përgjithshëm, b) Dentist; c) Specialist i Mjekësisë Familjare; d) Farmacist; e) Peditër; f) Gjinekolog-obstetër; g) Specialist i biokimisë klinike dhe h) Infermierë, mami, fizioterapistë dhe teknikë mjekësorë. <p>Përveç ofrimit të shërbimeve shëndetësore, sa herë që një profesionist i kujdesit shëndetësor takon një fëmijë të dyshuar si viktimë të shfrytëzimit seksual, aktivitete të paligjshme ose forma të tjera të punës së fëmijëve, ekziston një detyrim profesional i profesionistit të kujdesit shëndetësor që ta sjellë këtë në vëmendjen e Qendrës për Punë Sociale, dhe nëse ka ndonjë dëshmi se është kryer një krim i rëndë ndaj fëmijës, një raport gjithashtu duhet t'i bëhet policisë.</p>

Institucionet përgjegjëse	Detyrimet ligjore
Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave	<p>Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave (ZMNV) bën pjesë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, me obligimin për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të viktimave në sistemin e drejtësisë. Ky obligim rezulton kryesisht gjatë hetimit, ndjekjes penale dhe dënimit të një shkelësi. Ky obligim gjithashtu shtrihet në rastet kur shteti, përmes gjykatës, mund t'i kufizojë të drejtat dhe privilegjet e një shkelësi, si rezultat i një urdhri të mbrojtjes.</p> <p>ZMNV identifikon burimet për t'i përmbushur nevojat e viktimave të krimit dhe për të filluar rehabilitimin e tyre. ZMNV identifikon boshllëqet në dispozitat e shërbimeve, si dhe bashkëpunon dhe koordinohet me ofruesit e shërbimeve për të ofruar një përgjigje më të mirë për nevojat e viktimave bazuar në legjislacionin ekzistues në fuqi.</p>
Zyra e Punësimit	<p>Qendrat e punësimit operojnë në secilën komunë për t'i ndihmuar qytetarët në punësim përmes këshillimit dhe udhëzimit, përmes aftësimit ose riaftësimit profesional dhe përmes ndërmjetësimit në punësim.</p> <p>Grupet kryesore të synuara të qendrave të punësimit janë: të papunët afatgjatë gjysmë të kualifikuar dhe të pakualifikuar, të rinjtë të papunë (16-25 vjeç), veçanërisht fëmijët që kanë braktisur shkollën, komunitetet pakicë, gratë, njerëzit me nevoja të veçanta dhe punonjësit e ndërmarrjeve në rrezik të tepricës.</p>
Qendra e Aftësimit Profesional	<p>Aftësimi profesional ofrohet përmes një rrjeti prej tetë qendrave rajonale të aftësimit që veprojnë në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë dhe Doljane (Mitrovica Veriore) për kualifikimin dhe rikualifikimin e punëkërkuësve të regjistruar në Zyrat e Punësimit. Në të vërtetë, këto QAP-të ofrojnë trajnime falas për 30 profesione të ndryshme.</p>

Institucionet përgjegjëse	Detyrimet ligjore
Organizatat joqeveritare	<p>Sipas <i>Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare</i> (neni 8- Roli i sektorit joqeveritar)</p> <p>8.1. Personat juridikë, që nuk janë në sektorin qeveritar, duke përfshirë ndërmarrjet, organizatat dhe shoqatat vullnetare, organizatat fetare, grupet për vetë ndihmë dhe organizatat e tjera lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare janë të inkurajuara të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, qoftë me nismën e tyre ose me kontratë, në emër të drejtoratit komunal në rastin e shërbimeve lokale, ose në emër të Departamentit në rastin e shërbimeve në nivel të Kosovës.</p> <p>8.2. Për të mundësuar këtë, komunat dhe Departamenti i Mirëqenies Sociale u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave joqeveritare që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla.</p> <p>8.3. Çdo organizatë joqeveritare që ofron shërbime sociale dhe familjare duhet të regjistrohet pranë organit përkatës dhe të licencohet nga Departamenti i Mirëqenies Sociale, si edhe t'u përmbahet rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave lidhur me aktivitetet e tyre siç përcaktohen nga Ministria.</p> <p>8.4. Komunat mund të hyjnë në kontrata me organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe familjare brenda territorit të tyre, në emër të komunës, me kusht që kontratat e tilla të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime sociale dhe familjare në territorin e saj.</p> <p>8.5. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale mund të japë fonde dhe të ofrojë çfarëdo ndihme tjetër materiale, duke përfshirë lokalit, ose këshillat për organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime të veçanta sociale dhe familjare në nivel të Kosovës.</p> <p>8.6. Ministria lejohet të aderohet në kontrata me organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve specifike sociale dhe familjare në nivel të Kosovës.</p> <p>Sipas <i>Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit</i>:</p> <p>2. Organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare ofrojnë shërbime përkatëse për viktimat e trafikimit, ose me iniciativën e tyre, në emër të drejtorisë komunale në rast të shërbimeve komunale, ose në emër të Autoritetit Kombëtar në rast të shërbimeve në nivelin e Kosovës.</p>

PJESA 3

PËRMBLEDHJE

E PROCESIT TË

MENAXHIMIT TË RASTIT

3.1 Çfarë nënkupton menaxhimi i rastit⁹?

Menaxhimi i rastit është një proces i praktikuar nga punëtorët e shërbimeve sociale që mbështet ose udhëzon ofrimin e ndihmës së shërbimit social fëmijëve dhe familjeve të cenueshme dhe popullatës të tjetër në nevojë. Fillon kur një person ose familje është identifikuar se është cenuar ose është në një situatë të vështirë në të cilën kërkon ndihmë ose mbështetje sociale.

Praktika efektive e menaxhimit të rastit mund t'i fuqizojë familjet të kuptojnë dhe të përdorin shërbime të shumta përmes krijimit të një plani të rastit me fokus te fëmija dhe/ose familja, me qëllim kryesor të ndihmojnë individët dhe/ose familjet të përmirësojnë aftësitë e tyre të përballimit, të ngritin qëndrueshmërinë dhe të promovojnë një autonomi më të madhe, siguri dhe mirëqenie. Praktika shërben si hap i parë drejt vlerësimit të rezultateve të nivelit të klientit dhe përcakton kontrole të rregullta për të parë nëse ndërhyrjet kanë efektin e synuar ose nëse është e nevojshme të rishikohet plani i rastit.

Procesi i menaxhimit të rastit gjithashtu mbështet praktikën e menaxhimit të mirë sepse kërkon që punonjësit e shërbimeve sociale të identifikojnë se cilat janë shërbimet sociale të disponueshme dhe ku ka boshllëqe. Ndihton gjithashtu në monitorimin e performancës së stafit dhe vullnetarëve, promovon transparencën dhe përgjegjshmërinë, si dhe ndihmon në informimin dhe planifikimin e buxhetit.

3.2 Cilat janë parimet udhëheqëse në menaxhimin e rastit?

Menaxhimi i rastit është ndërtuar dhe informuar nga disa parime kryesore që pasqyrojnë instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve dhe të drejtat e njeriut, si dhe vlerat e punës sociale, të cilat mbështesin tërë procesin e menaxhimit të rastit:

Rritja e qëndrueshmërisë dhe përmirësimi i cilësisë së jetës: Qëllimi kryesor i menaxhimit të rastit duhet të jetë ngritja e nivelit të rezistencës së klientit dhe familjes së tij. Zhvillimi i një plani të individualizuar të rastit duhet të përfshijë qëllime afatshkurtra dhe ato afatgjata, të cilat pasqyrojnë këtë parim thelbësor dhe aktivitetet e përshkruara të nevojshme për të arritur rezultatin e dëshiruar.

⁹ Ky kapitull është hartuar bazuar në Konceptet Thelbësore dhe Parimet e Menaxhimit Efektiv të Rastit: Qasjet për Fuqinë Punëtore të Shërbimit Social, Grupi Global i Interesit të Menaxhimit të Rasteve-Aleancës të Shërbimit Social, 2018, në dispozicion në <https://bettercarenetwork.org/sites/default/files/Case-Management-Concepts-and-Principles.pdf>

Bashkëpunimi dhe partneriteti: Të gjithë njerëzit e përfshirë në menaxhimin e rastit duhet të punojnë në bashkëpunim me klientin ose familjen e tij. Punëtori i shërbimit social, i cili zbaton një proces të menaxhimit të rastit, duhet të sigurohet që klienti të kuptojë se çfarë po ndodh duke i dhënë informata të plota dhe të sakta në kohën e duhur. Klienti (klientët), përfshirë fëmijët, sipas moshës së tyre dhe aftësive zhvillimore, duhet të angazhohen në të gjitha hapat e procesit dhe të jenë të autorizuar për të ndihmuar në marrjen e vendimeve dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në përcaktimin dhe arritjen e qëllimeve të identifikuar.

Punëtori i shërbimit social gjithashtu duhet të punojë me organizata të tjera, grupe të komunitetit dhe individë për të siguruar që fëmijët dhe familjet të marrin ndihmën më të mirë duke bashkëpunuar dhe bashkërenduar me publikun dhe ofruesit e tjerë që janë në gjendje të ofrojnë mbështetje ose të luajnë një rol brenda planit të rastit.

Mos bëj dëm: Kjo nënkupton të menduarit për të drejtat dhe interesat më të mirë të secilit anëtar të bashkësisë familjare dhe sigurimin se qasja ose praktika është në interesin e tyre më të mirë dhe nuk e përkeqëson situatën.

Respektimi dhe promovimi i pikave të forta të klientit: Punëtori i shërbimit social duhet të punojë së afërmi me klientin dhe të bazohet në burimet ekzistuese, përparësitë dhe kontributin e mundshëm të klientit, në vend se të ketë një qasje e cila fokusohet ekskluzivisht në nevojat ose problemet me të cilat përballet klienti. Përparësitë dhe burimet e klientit duhet të bazohen dhe të integrohen në procesin e menaxhimit të rastit për të ndihmuar në informimin e vendimeve rreth atij veprimi që mund të kryejë klienti në mënyrë të pavarur, si dhe cilat ndërhyrje ose shërbime shtesë mund të kërkojë klienti, në çfarë mase dhe kush mund të ofrojë shërbime, në çfarë intensiteti dhe për sa kohë.

Respektimi i diversitetit, kulturës dhe traditës: Të gjithë personat e përfshirë në menaxhimin e rastit duhet të kenë njohuri dhe t'i respektojnë kulturat dhe traditat vendase që përdorin në fushën në të cilën punojnë. Respektimi i diversitetit, kulturës dhe traditës nënkupton gjithashtu kërkimin dhe përdorimin e burimeve të komunitetit kurdo që është e mundur, me rastin e përcaktimit të qëllimeve dhe planifikimit të rastit. Kjo nënkupton gjithashtu që aspektet e ndryshme, siç janë statusi socio-ekonomik, raca, orientimi seksual, mosha, gjinia, feja ose aftësia, të pranohen, respektohen dhe trajtohen në mënyrë të barabartë. Proceset e menaxhimit të rastit gjithashtu duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që të jenë gjithëpërfshirëse dhe të angazhojnë siç duhet klientët me aftësi të kufizuara.

Respektimi dhe reflektimi i një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut: Menaxhimi i rastit duhet të udhëhiqet nga parime që përshkruhen në instrumentet përkatëse të bazuara në të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve. Përderisa vlerëson dhe respekton praktikën kulturore, konteksti është gjithashtu i rëndësishëm. Përmbushja e të drejtave duhet të shfuqizojë çdo praktikë ose traditë që mund të konsiderohet e dëmshme. Për shembull, martesat e fëmijëve ose puna e fëmijëve mund të jetë një traditë vendore, por gjithashtu është një shkelje e të drejtave të fëmijëve.

Pëlqimi për të marrë pjesë në menaxhimin e rastit: Menaxhimi i rastit duhet të arrihet në atë mënyrë që inkurajon pjesëmarrjen aktive të klientit. Sidoqoftë, për të iniciuar këtë proces

kërkohe një shpjegim i qartë i procesit të menaxhimit të rastit, roit dhe përgjegjësive, si dhe një mundësi për klientin ose një anëtar të bashkësisë familjare, varësisht se kush ka kapacitet vendimmarrës, të ofroj pëlqimin verbal ose me shkrim. Kjo qasje ndihmon në lehtësimin e bashkëpunimit të klientit dhe agjencisë që menaxhon rastin dhe një rol aktiv të klientit brenda hapave të ndryshëm të procesit të menaxhimit të rastit.

Konfidencialiteti: Punonjësi i shërbimit social nuk duhet të ndajë informata rreth një klienti ose bashkësisë familjare, përveç nëse është e nevojshme një gjë e tillë. Për shembull, në një takim diskutimi të rastit (referuar edhe si konferencë për rastin) ose me organizata ose individë të tjerë për të cilët klienti mendon se do të ishte e dobishme për t'u angazhuar (për shembull një fqinj që mund të ofroj kujdes për fëmijë), disa detaje të rastit të klientit mund të jenë të rëndësishme për t'u ndarë. Është e rëndësishme që informatat rreth rastit të mos diskutohen në shtëpi, me miqtë dhe fqinjët, ose në vendet ku njerëzit e tjerë mund të dëgjojnë ato informata. Regjistrimet e shkruara gjithashtu duhet të jenë konfidenciale dhe të ruhen në një vend të sigurt, ku mund të qasen vetëm nga menaxheri i rastit. Nëse ka regjistrime elektronike, ato duhet të mbrohen me fjalëkalim. Punonjësi i shërbimit social duhet të diskutojë konfidencialitetin me klientin në mënyrë që ai/ajo të jetë i qartë dhe të jep pëlqimin se kush do të ketë qasje në informatat rreth situatës së tij/saj.

Sigurimi i cilësisë në menaxhimin e rastit: Një proces i menaxhimit të rastit duhet të përshkruhet në procedurat standarde të veprimit (PSV), mjetet dhe instrumentet e dizajnuar për punonjësit profesional dhe para profesional të shërbimit social. PSV-të synojnë sigurimin e proceseve dhe qasjeve të standardizuara brenda hapave të ndryshëm të zbatimit të menaxhimit të rasteve dhe duhet të kenë sigurimin e cilësisë si një objektivi të përgjithshëm. Ka mënyra të ndryshme për sigurimin e cilësisë. Disa shembuj përfshijnë:

- **Përshkrimet e vendit të punës:** Të gjithë zyrtarët e shërbimit social përgjegjës për zbatimin e menaxhimit të rasteve duhet të kenë përshkrime të qarta të vendit të punës që përcaktojnë kompetencat dhe/ose cilësitë e nevojshme për të kryer menaxhimin e rasteve, si dhe të përshkruajnë funksionet ose detyrat e tyre specifike. Përshkrimet e vendit të punës u mundësojnë organizatave të sigurohen që punëtorët e tyre janë aftësuar në një standard të dakorduar të menaxhimit të rasteve dhe vlerësohen kundrejt kompetencave dhe detyrave të përshkruara.
- **Mbikëqyrja:** Praktika e mirë njih nevojën për mbikëqyrje dhe vëzhgim.
- Kjo është veçanërisht e rëndësishme për anëtarët e fuqisë punëtore të shërbimit social të cilët zbatojnë praktikën e menaxhimit të rasteve. Mbikëqyrja mbështetëse përfshin takimet e rregullta ndërmjet mbikëqyrësit dhe punonjësve të shërbimeve sociale që kryejnë menaxhimin e rasteve dhe bien dakord për planet e punës, bëjnë rishikimin e çështjeve individuale, mbështesin marrjen e vendimeve, ofrojnë mbështetje për të përballuar stresin dhe për të identifikuar nevojat për trajnim në punë dhe mundësitë e zhvillimit profesional. Mbikëqyrja gjithashtu mund të përfshijë seanca në grup, gjatë të cilave grupet e punonjësve të shërbimit social shqyrtojnë rastet së bashku dhe ofrojnë mbështetje për kolegët. Përgjegjësitë e mbikëqyrjes duhet të kuptohen nga mbikëqyrësi

dhe i mbikëqyruri dhe të jenë të vendosura me shkrim në përshkrimet e vendit të punës dhe PSV-të.

- **Monitorimi dhe Vlerësimi:** Nevojitet një sistem për monitorim dhe vlerësim i cili përfshin një mekanizëm për mbledhjen e të dhënave, shkëmbimin e të dhënave dhe analizimin e tyre në mënyrë që menaxherët të dinë se çfarë po funksionon mirë dhe ku duhet të bëhen përmirësimet. Këto të dhëna, veçanërisht kur gjurmohen përmes sistemeve të informacionit për menaxhimin e rasteve, mund të ndihmojnë në rritjen e të kuptuarit mbi ndikimet dhe përfitimet nga praktika e menaxhimit të rasteve, e cila është e dobishme gjatë avokimit për burime.

3.3 Rëndësia e mekanizmave për koordinim

Për të arritur ndryshimet që nevojiten për përmirësimin e jetës së anëtarëve të njësisë familjare, ndonjëherë, siç u përmend më lart, shumë njerëz dhe organizata duhet të përfshihen dhe veprimet dhe ndërhyrjet e tyre individuale duhet të koordinohen. Zyrtari i shërbimit social zakonisht lehtëson këtë proces me ndihmën dhe mbikëqyrjen e ofruar nga mbikëqyrësi i tij/saj. Kjo mund të bëhet duke mbajtur takime/ konferenca të rastit me:

- klient individual;
- anëtarë të familjes (për shembull, me anëtarët e familjes së ngushtë ose njerëzit e tjerë që jetojnë në familje); dhe/ose
- ofruesit e shërbimeve (për shembull, mësuesit, mjekët dhe infermierët, përfaqësuesit e ofruesve të shërbimeve të OJQ-ve).

Një formë tjetër e koordinimit është kur ofruesit e shërbimeve lokale takohen rregullisht, si për shembull përmes takimeve të komunitetit ose takime koordinuese komunale, për të diskutuar dhe planifikuar rolet dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe për të diskutuar se si të punojnë së bashku. Ata gjithashtu mund të flasin për mënyrat për t'iu qasur rasteve më të ndërlikuara. Për shembull, një qeveri lokale mund të krijojë një komitet për mbrojtjen e fëmijëve, ku përfaqësuesit do të mbledheshin çdo tre muaj për të diskutuar përgjegjësitë lokale për mbrojtjen e fëmijëve¹⁰.

¹⁰ Ligji për Mbrojtje të Fëmijës rregullon koordinimin ndërinstytucional përmes Ekipeve për të Drejta të Fëmijës në nivel të vendim marrësve në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Funksionimi i këtyre ekipeve do të rregullohet përmes një UA të veçantë.

PJESA 4

PROCEDURAT STANDARDE
TË VEPRIMIT PËR
MENAXHIMIN E RASTIT
TË FËMIJËVE NË PUNË

4.1 Çështjet kryesore për shqyrtim në menaxhimin e rasteve të fëmijëve

Qëllimi kryesor i menaxhimit të rasteve për mbrojtjen e fëmijëve është për t'iu përgjigjur fëmijëve që përjetojnë ose janë në rrezik të abuzimit, neglizhencës, dhunës dhe shfrytëzimit përmes shërbimeve individuale të punës sociale. Në përputhje me parimet kryesore të procesit të menaxhimit të rasteve, çështjet e mëposhtme duhet të merren parasysh në të gjitha rastet e proceseve të menaxhimit të rasteve që kanë për qëllim mbrojtjen e fëmijëve:

- **Pjesëmarrja e fëmijës të angazhuar në punë** si aktor aktiv i rehabilitimit të tij në çdo hap të procesit. Menaxheri i rastit duhet të sigurojë pjesëmarrjen e fëmijës në të gjitha fazat e zhvillimit të planit të shërbimit, përfshirë edhe kur përcakton përgjegjësi specifike për të dyja institucionet që ofrojnë shërbime dhe fëmijën. Teorikisht, planifikimi i aktiviteteve duhet të marrë formën e një kontrate. Kjo është me rëndësi thelbësore për të forcuar autonominë e fëmijës dhe përgatitjen e tij për riintegrim në shoqëri në mënyrë kontraktuale/të shikimit përpara.
- **Përfshirja e familjes** nëse të drejtat e prindërve nuk pezullohen me vendim të gjykatës për shkak të një kërcënimi të drejtpërdrejtë për sigurinë e fëmijës, familja duhet të përfshihet në procesin e rehabilitimit. Nevojat direkte materiale të familjes duhet të adresohen përmes zgjidhjeve. Besimet jofunksionale të familjes ndaj shkollës, punës së fëmijëve, etj., duhet të diskutohen në diskutime të hapura ku duhen shkëmbyer argumente dhe kundër-argumente. Mbyllja e rastit do të ndodhë vetëm kur këto besime të kenë ndryshuar.
- **Referimi** në shërbimet ekzistuese bazuar në hartëzimin e shërbimeve të disponueshme dhe procedurat e përcaktuara; menaxhimi i rasteve nënkupton organizimin dhe koordinimin e një rrjeti aktivitësh, shërbimesh zyrtare dhe joformale dhe mbështetje të dizajnuara për të optimizuar mirëqenien e fëmijës.
- **Menaxhimi i centralizuar i informacionit** me një dosje të përbërë nga formate të paracaktuara, kritere të para-dakorduara për zbulimin e informacionit për personat e autorizuar. Menaxheri i rastit është përgjegjës për koordinimin e informacionit, konsolidimin e tij dhe analizën vijuese.

Tri dimensione ndërsektoriale të procesit të menaxhimit të rasteve janë dokumentacioni, mbikëqyrja, kontrolli i cilësisë dhe rishikimi i përdorimit, si dhe marrëdhënia e duhur.

Dokumentacioni

Një sistem gjithëpërfshirës për mbledhjen, ruajtjen dhe shkëmbimin e informacionit për menaxhimin e rasteve është i rëndësishëm në përmirësimin e efektivitetit të përgjithshëm të shërbimeve të menaxhimit të rasteve. Proceset e zakonshme të menaxhimit të informacionit në QPS përfshinë dokumentacionin, mbajtjen e regjistrave, menaxhimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe ndarjen e analizës së informacionit me akterët e jashtëm.

Dokumentacioni duhet të jetë zinxhir i pandërprerë i informacionit, andaj Menaxherët e Rasteve duhet t'i regjistrojnë të gjitha fazat e ndërhyrjes dhe të përshkruajnë në mënyrë kronologjike informacionin, aktivitetet dhe përdorimin e shërbimeve, si dhe veprimet, reagimet dhe arritjet e fëmijës.

Dokumentacioni i duhur mundëson shërbime efektive dhe të përgjegjshme për menaxhimin e rasteve. Informacioni i grumbulluar direkt dhe indirekt nga fëmijët dhe familjet e tyre, si dhe nga ofruesit e shërbimeve duhet të ruhet nga QPS. MR duhet t'i plotësojë me saktësi të gjitha mjetet përkatëse të menaxhimit të rasteve për të mundësuar:

- Nga brenda: Mbikëqyrjen e cilësisë së proceseve dhe shërbimeve, identifikimin e sfidave në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në punë dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit.
- Nga jashtë: Monitorimin e përputhshmërisë me standardet për mbrojtjen e fëmijëve në punë dhe verifikimin nga auditorët se janë siguruar shërbime për financim. Ai gjithashtu mundëson identifikimin e zbrazëtirave në nivel sistemi; prandaj, të dhënat e menaxhimit të rasteve duhet të analizohen në mënyrë periodike dhe të përdoren për të informuar zhvillimin/rishikimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve nga puna, p.sh. në mbledhjet e Ekipeve Komunale për të Drejtat e Fëmijëve (që do të themelohen bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës).

Mbikëqyrja dhe kontrollimi i cilësisë

Për t'u siguruar se janë duke u ofruar shërbime cilësore dhe fëmija po merr atë që atij i duhet për të lëvizë drejt qëllimeve të tij, për të kontrolluar përshtatshmërinë e vlerësimeve, planeve, referimeve, për t'u siguruar se monitorimi/koordinimi është duke u kryer për të gjitha rastet dhe për të vlerësuar nëse institucioni po ofron në mënyrë efektive dhe efikase nivelin e kujdesit të nevojshëm nga fëmijët e angazhuar në punë, ekziston nevoja për:

- Mbikëqyrjen e Menaxherëve të Rasteve;
- Kontrollimin e cilësisë/rishikimin e dosjeve; dhe
- Shqyrtimin e përgjithshëm të procesit të MR.¹¹

¹¹ Një shabllon për rishikimin e përgjithshëm të Procesit të MR është dhënë në Pjesën 6

Në këtë drejtim, mbikëqyrësi i Menaxherit të Rastit është mbrojtësi kryesor i fëmijës dhe mbrojtja kryesore për Menaxherin e Rastit.

Marrëdhënia

Marrëdhënia e duhur i mundëson fëmijës dhe familjes së tij që Menaxherin e Rastit ta shohin si dikë të cilit mund t'i besojnë dhe Qendrën për Punë Sociale si një institucion që përkujdeset për mirëqenien e tij. Kjo mund të realizohet më së miri nëse Menaxheri i Rastit:

- Mban kufijtë e duhur profesional;
- Ndërton marrëdhënie të besimit.

4.2 Hapat kryesorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në punë

Procesi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në punë përbëhet nga disa faza ose hapa që janë më shumë rekursiv sesa linear dhe që zbatohen deri në plotësimin e nevojave dhe interesave të fëmijës. Hapat e procesit¹² janë:

Hapi 0: Identifikimi i fëmijës së cenueshëm

Hapi 1: Referimi i fëmijës në Qendrën për Punë Sociale

Hapi 2: Ekzaminimi, regjistrimi dhe caktimi i Menaxherit të Rastit

Hapi 3: Vlerësimi i rastit, përfshirë vlerësimin fillestar dhe gjithëpërfshirës

Hapi 4: Plani i shërbimeve

Hapi 5: Zbatimi i planit të shërbimeve, rishikimi dhe monitorimi i rastit

Hapi 6: Vlerësimi i zbatimit të planit të shërbimeve

Hapi 7: Mbyllja e rastit

Siç u tha më lart, këta hapa nuk janë linearë, që do të thotë se nuk e përfundojmë një hap dhe ta largojmë nga lista jonë si i përfunduar. Hapat mund të rishikohen sipas nevojës deri sa të arrihet rezultati i dëshiruar. Për shembull, gjatë përcjelljes së një rasti, mund të identifikohen probleme të reja. Në këtë pikëpamje do të ktheheshit në hapin e planifikimit. Prandaj, MR-të duhet të analizojnë vazhdimisht situatën e fëmijës dhe familjes së tij dhe të përdorin në mënyrë fleksibile hapat e menaxhimit të rasteve si një udhëzues për të organizuar punën e tyre.

¹² Këta hapa përcaktohen nga paketa e Formularëve të Menaxhimit të Rasteve të aprovuar nga MPMS në Mars 2020

4.3 Udhëzime për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në punë

Hapi 0: Identifikimi i fëmijës së cenueshëm

Secili anëtar i shoqërisë mund të veprojë si sy dhe vesh në terren për identifikimin e fëmijëve të cenueshëm dhe për t'i sjellë ata në vëmendjen e Qendrës për Punë Sociale për mbrojtje. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 26:

- Çdo person që vëren ose ka informacion për një situatë ose akt që mund fëmija mund t'i nënshtrohet, ose që ndaj fëmijës është ushtruar ndonjë formë e dhunës fizike ose mendore, keqtrajtim, braktisje, abuzim, neglizhim dhe shfrytëzim është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në polici ose në Qendrën përkatëse për punë sociale (Neni 26, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës).
- Prindi ose kujdestari si dhe çdo person tjetër, nëse ka arsye për të dyshuar se ndaj fëmijës është ushtruar dhunë, abuzuar, keqtrajtuar, shfrytëzuar, është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në Polici ose në Qendrën përkatëse për punë sociale.
- Profesionisti për mbrojtjen e fëmijës, që përfshinë, por nuk kufizohet në: edukator, mësimdhënës, mjek, stomatolog, infermier, psikolog, **punëtor** social, polic, çdo ofrues i shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës publik, privat ose përfaqësues i organizatave joqeveritare për mbrojtjen e fëmijës, dhe kushdo që ka arsye për të dyshuar se një fëmijë ka pësuar dhunë, **është** abuzuar, keqtrajtuar, braktisur, shfrytëzuar apo neglizhuar, është i obliguar që rastin ta raportojë me shkrim ose gojarisht në polici, në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave ose në QPS.

Hapi 1: Referimi i fëmijës në Qendrën për Punë Sociale

Ky hap parasheh raportim zyrtar të një shqetësimi për një fëmijë në rrezik të dëmtimit nga ndonjë person, profesionist, institucion ose organizatë brenda komunitetit. Referimi i fëmijës mund të bëhet drejtpërdrejt në QPS, përmes telefonit ose mjeteve të tjera të komunikimit. Sipas Kornizës së Standardeve Minimale për Shërbimet e Punës së Fëmijëve, çdo partner i mandatuar rastin e identifikuar do t'ia paraqes QPS-së brenda një maksimumi prej 24 orësh nga koha e identifikimit të rastit të tillë.

Kutia 3: Udhëzime specifike për plotësimin e Formularit për MR 1: Referimi i rastit¹³

Referimi i rastit

Informacioni bazë i nevojshëm për referimin e një rasti, përmban:

- Informacione mbi mënyrën se si të qaseni të fëmija (regjistrimi në pjesën: të Dhënat e Rastit)
- Informacione thelbësore në lidhje me arsyen se pse bëhet referimi, rreziqet të cilave fëmija i ekspozohet (të regjistrohet në pjesën: Arsyet e Referimit)
- Detaje për zyrtarin e punës sociale që ka marrë njoftimin dhe datën kur është bërë referimi.

Çdo dokument i dorëzuar me rastin e referimit duhet të regjistrohet.

Informacione të tjera janë gjithashtu të rëndësishme dhe duhet të merren për aq sa është e mundur, por nuk janë të domosdoshme për paraqitjen e rastit.

Në rast të referimit nga institucionet dhe organizatat publike, një kopje e formularit të plotësuar të referimit i jepet palës që e ka paraqitur rastin.

Hapi 2: Ekzaminimi, regjistrimi dhe caktimi i Menaxherit të Rastit

Sapo rasti i punës së fëmijëve t'i referohet Qendrës për Punë Sociale (QPS), QPS do të emërojë Menaxherin e Rastit (MR) brenda 24 orësh¹⁴. Si bazë për emërimin e MR, bëhet ekzaminimi fillestar për të mbledhur të dhëna themelore. Për më tepër, si pjesë e procesit të regjistrimit, detajet e rastit verifikohen dhe fëmija dhe familja e tij informohen mbi procesin e menaxhimit të rastit, informacionin që duhet të mblidhet, si do të ruhet dhe me kë do të ndahet, përfshirë konfidencialitetin dhe kufijtë e tij. Kjo do t'i mundësojë prindit/kujdestarit të merr vendim të informuar për pranimin e shërbimeve.

¹³ Shih Pjesën 6: Formulari i Menaxhimit të Rastit: Referimi i Rasteve

¹⁴ Në rastet e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, kujdestari ligjor do të emërohet brenda 14 ditëve.

Kutia 4: Udhëzim specifik për plotësimin e formularit të MR 2:
Caktimi i Menaxherit të Rastit¹⁵

Caktimi i Menaxherit të Rastit

Të dhënat paraprake që duhet të merren nga QPS para vazhdimit me procesin e menaxhimit të rastit përfshijnë:

- Shënime të përgjithshme për rastin, përfshirë emrin e fëmijës, emrin dhe mbiemrin e prindërve; datën e lindjes; vendin e lindjes; gjininë; adresën; numrin personal; numrin e telefonit.
- Faktet themelore dhe provat për paraqitjen e rastit, përfshirë rreziqet e menjëhershme ndaj të cilave fëmija është i ekspozuar. Nëse kërkohet veprim urgjent, kjo duhet të theksohet në këtë pjesë. Forma dhe mënyra e ndihmës së menjëhershme përcaktohet në varësi të gjendjes së përgjithshme shëndetësore, fizike, emocionale dhe të sigurisë së fëmijës.

Gjatë procesit të regjistrimit, QPS duhet të kërkojë nga prindi/kujdestari i fëmijës leje për të ofruar shërbime. Për të marrë pëlqim të informuar, fëmijës dhe prindërit/kujdestarit të tij duhet t'i ofrohen informata të mjaftueshme (shih më lart).

Data kur njoftimi për rastin dorëzohet te Shefi i Shërbimit, data e takimit me fëmijën dhe prindin/kujdestarin e tij dhe përshkrimi i shkurtër i rastit plotësohet nga Shefi i Shërbimit ose zyrtari i autorizuar. Konfirmimi për urgjencën e intervenimit duhet të bëhet edhe nga ana e Shefit të Shërbimit (nëse ka diçka të tillë).

Bazuar në ato që u thanë më lart, Menaxheri i Rastit caktohet nga Shefi i Shërbimit ose zyrtari i autorizuar. Kjo i mundëson Shefit të Shërbimit të menaxhojë ngarkesën me raste ndërmjet punëtorëve të shërbimeve sociale dhe të ndjekë më mirë progresin e tyre.

Formulari nënshkruhet gjithashtu nga punëtori i shërbimeve sociale i caktuar për menaxhimin e rastit.

Hapi 3: Vlerësimi i rastit, përfshirë vlerësimin fillestar dhe gjithëpërfshirës

MR, bazuar në vlerësim paraprak të situatës së dhënë, hap rastin dhe planifikon procesin e vlerësimit. Vlerësimi i rastit vendos bazën për tërë procesin e menaxhimit të rastit. Mbledhja e fakteve dhe dëshmive gjithëpërfshirëse që përcaktojnë planin e shërbimeve **për fëmijën është thelbësore sa i përket vlerësimit të duhur të nevojave dhe kapaciteteve dhe sa i përket formulimit të planeve për ofrimin e ndihmës më të përshtatshme**. Si pasojë, i gjithë informacioni përkatës duhet të mbledhet për të hartuar përmbledhjen e rastit dhe për të planifikuar atë që duhet të bëhet për t'i zgjidhur problemet e identifikuara, duke përfshirë:

- informacionin gjithëpërfshirës për situatën në të cilën është përfshirë fëmija,
- nevojat e menjëhershme dhe gjendjen emocionale e fëmijës sa i përket mbrojtjes dhe mbështetjes psikologjike;
- sistemet dhe rrjetet mbështetëse.

Është e rëndësishme që vlerësimi të jetë i organizuar në vlerësimin fillestar dhe gjithëpërfshirës.

¹⁵ Shih Pjesën 6- Formulari i menaxhimit të rasteve: Caktimi i Menaxherit të Rastit

Kutia 5: Udhëzime specifike për plotësimin e Formularit 3 të MR: Vlerësimi i rastit¹⁶**Vlerësimi fillestar**

Vlerësimi fillestar ka për qëllim identifikimin e rrezikut të menjëhershëm dhe përcaktimin e veprimeve prioritare të shpëtimit. Të dhënat që duhet të mblidhen për këtë qëllim përfshijnë: **informacione të përgjithshme për fëmijën, informacione mbi natyrën e punës (sektori dhe rreziqet që i ekspozohet fëmija) dhe kategorizimi i nivelit të rrezikut.** Procesi fillestar i vlerësimit do të përfundohet nga MR brenda 2 orëve.

Për t'i vlerësuar rreziqet të cilave fëmija u ekspozohet, MR duhet të shënjojë kutinë e duhur bazuar në informacionet më poshtë¹⁷. Nëse duhet, mund të shënjohe më shumë se një kuti.

Rreziqet nga mjedisi i punës:

- Ekspozimi ndaj temperaturave të larta ose të ulëta, ose ndaj zhurmave ose dridhjeve;
- Ekspozimi ndaj rreziqeve të trafikut;
- Ekspozimi ndaj dhunës dhe abuzimit të mundshëm;
- Ekspozimi ndaj kushteve të këqija higjienike, prishjes së dheut;
- Ekspozimi ndaj substancave biologjike, kimike dhe toksike;
- Ekspozimi ndaj substancave kancerogjene, pluhurit dhe gazrave;
- Ekspozimi ndaj radioaktivitetit.

Rreziqet nga mjetet e punës:

- Puna me mjete/pajisje të tjera të rrezikshme të mprehta ose me makineri bujqësore.

Rreziqet nga natyra e punës:

- Ngritja dhe mbajtja e kohëpaskohshme e peshës: mbi 15 kg (mashkull) -10 kg (femra);
- Ngritja dhe mbajtja e vazhdueshme e peshës: mbi 10 kg (mashkull) dhe mbi 5 kg (femër);
- Puna në lartësi mbi 2 m;
- Pozicioni i papërshtatshëm i punës (qëndrimi i përkulur për periudha të gjata kohe);
- Puna nën tokë, nën ujë dhe në hapësira të mbyllura.

Rreziqet nga kohëzgjatja e punës:

- Ndërhyrje e orarit të punës me frekuentimin e shkollës;
- Puna e natës (midis orës 20:00 dhe 6:00);
- Angazhimi i fëmijëve 5-11 në aktivitete ekonomike të paktën 1 orë në javë dhe/ose në shërbime shtëpiake të papaguara për më shumë se 21 orë në javë;
- Angazhimi i fëmijëve 12-14 në aktivitete ekonomike të paktën 14 orë në javë dhe/ose në shërbime shtëpiake të papaguara për më shumë se 21 orë në javë;
- Angazhimi i fëmijëve 15-17 në aktivitete ekonomike për më shumë se 43 orë në javë.

Nëse niveli i rrezikut është i mesëm ose i ulët, që do të thotë se nuk ka rrezik të menjëhershëm për jetën ose sigurinë e fëmijës, atëherë MR do të vazhdojë me vlerësimin. Nëse niveli i rrezikut është i lartë atëherë fillimisht nevojitet veprim i menjëhershëm për ta shpëtuar fëmijën nga rreziku. P.sh. nëse puna e fëmijës përfshin aktivitete me rrezikshmëri të lartë (siç mund të jetë operimi me makineri bujqësore, puna në orët e vona të natës, puna në deponi të mbeturinave¹⁸, etj.) atëherë fillimisht duhet siguruar që fëmija ta ndërpres aktivitetin përkatës; pastaj vazhdohet me vlerësimin e plotë gjithëpërfshirës, mbi të cilin planifikohen veprimet tjera të nevojshme.

16 Shih Pjesën 6 - Formulari i menaxhimit të rasteve: Vlerësimi i rastit

17 Rreziqet më poshtë i referohen PRrF dhe nuk përfshijnë përdorimin e fëmijëve për veprimtari të paligjshme, pornografi, prostitucion ose viktima të trafikimit, pasi kërkohet mbrojtje e menjëhershme në raste të tilla pa ndonjë vlerësim të rrezikut.

18 Shih më tepër në UA 05/2013

Vlerësimi gjithëpërfshirës është vlerësim i thelluar që synon t'i japë MR kuptim tërësor të situatës së fëmijës, të gjenerojë informacion për të udhëzuar zhvillimin e planit të shërbimeve dhe për t'i identifikuar aspektet që mund të përdoren për të informuar vendimet e MR lidhur me natyrën e ofruesve të tjerë të shërbimeve që mund të ndërhyjnë në situatën e fëmijës për t'i adresuar shqetësimet specifike. Vlerësimi duhet të mbulojë nevojat fizike, psikologjike, emocionale dhe sociale, duke përfshirë të kuptuarit të karakteristikave kulturore të mjedisit, si dhe hartëzimin e shërbimeve në dispozicion në komunitetin ku fëmija jeton.

Vlerësimi i nevojave duhet të bëhet në konsultim të ngushtë me fëmijën dhe familjen e tij. Si rrjedhojë, hapi i parë dhe më i rëndësishëm është angazhimi dhe krijimi i marrëdhënies me fëmijën, ndërtimi i besimit dhe bërja e situatës sa më të përshtatshme dhe të sigurt. Si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm, MR duhet të krijojë dosje të të gjitha të dhënave, informacioneve dhe përfundimeve përkatëse për profilin e rastit bazuar në ato informacione. Përmbajtja e dosjes së fëmijës ruhet në fshehtësi të lartë dhe vihet në dispozicion vetëm për profesionistët që janë duke punuar mbi rastin.

Kutia 6: Udhëzime specifike për plotësimin e Formularit 3 të MR: Vlerësimi i rastit¹⁹**Vlerësimi gjithëpërfshirës i rastit**

Vlerësimi gjithëpërfshirës do të përfundojë brenda 7 ditëve, nga momenti i hapjes së rastit. Në këtë proces MR do të përdorë:

- Intervista/diskutime me fëmijën, prindërit/kujdestarin, anëtarët e tjerë të familjes, mësuesin dhe palët e tjera, sipas rastit dhe sipas nevojës;
- Vëzhgimi (p.sh. i shëndetit fizik të fëmijës, mirëqenia emocionale dhe mendore, cilësia e kushteve të banimit).

Informacioni i parë i mbledhur pas vlerësimit paraprak është për perceptimet e fëmijës mbi punën dhe arsyet e angazhimit në punë (Faqja 2 e Formularit 3 të MR). Të dhëna të tjera që mund të mblidhen gjatë kësaj interviste me fëmijën përfshijnë:

- Të dhënat mbi problemet shëndetësore dhe trajtimin shëndetësor (faqja 5 e Formularit 3 të MR);
- Perceptimet e fëmijës në lidhje me familjen e tij dhe marrëdhëniet shoqërore (faqja 6 e Formularit 3 të MR);
- Të dhënat mbi arsimin, përdorimin e kohës së lirë dhe interesat e fëmijës (faqja 7 e Formularit 3 të MR);
- Qëllimet/perspektiva e fëmijës për të ardhmen e tij/saj (faqja 10 e Formularit 3 të MR - Indikacionet për planin e shërbimit).

Kohëzgjatja e intervistës me fëmijën nuk duhet të kalojë 45 minuta. Kur komunikon me fëmijën, MR duhet:

- ✓ T'i kushtojë vëmendje asaj që fëmija thotë dhe bën, dhe mos të mos bëjë asgjë tjetër gjatë asaj kohe.
- ✓ Të përdorë gjuhë të thjeshtë: mendo për fjalët që përdor. Fjalitë e gjata do të hutojnë fëmijët.
- ✓ Të përdorë përvojën e fëmijës për t'i shpjeguar gjërat.
- ✓ Të jetë miqësor dhe i afrueshëm. Mos shprehni mosinteresim, zemërim ose shqetësim deri sa fëmija flet, sepse kjo do ta shtyjë atë të ndalojë së foluri. Mbaj kontaktin me sy.
- ✓ Ta dëgjojë dhe t'i përgjigjet aktivisht fëmijës. Mundohu t'i përgjigjesh pyetjeve të tij sa më sinqerisht të jetë e mundur.
- ✓ Të ulet në të njëjtin nivel si fëmija.
- ✓ Të sigurojë kohë dhe hapësirë të përshtatshme dhe të bisedojë me fëmijën në një mjedis të përshtatshëm dhe të favorshëm.
- ✓ Të sigurohet që fëmija e di që do të respektohet konfidencialiteti.
- ✓ Të jetë empatik - trego që e kupton se si është ndjerë fëmija (pa thënë se ashtu po ndihesh edhe ti).
- ✓ Të mos ketë frikë nga heshtja kur fëmija ka nevojë për kohë dhe hapësirë për të mbledhur mendimet.

¹⁹ Shih Pjesën 6 - Formulari i Menaxhimit të Rasteve: Vlerësimi i rasteve

Vlerësimi gjithëpërfshirës i rastit

- ✓ Të inkurajojë fëmijën duke pohuar me kokë ose duke buzëqeshur, por jo shumë shpesh për të mos e shpërqendruar fëmijën.
- ✓ Të bëjë pyetje të hapura.
- ✓ Të përmbledhë dhe sqarojë rregullisht në mënyrë që të jetë i sigurt në lidhje me atë që fëmija ka thënë: sigurohu që të kuptosh se çfarë fëmija po përpiqet të thotë dhe sqaro atë që fëmija di për situatën.
- ✓ Të mos nxitojë fëmijën: ji i durueshëm, ndiqe ritmin e fëmijës dhe lejoje atë që të shpreh emocionet e veta.

Të dhënat mbi shëndetin fizik (peshën, gjatësinë), mirëqenien emocionale dhe mendore duhet të shënohen bazuar në vëzhgimin e MR. Nëse është e nevojshme, MR mund të kërkojë një mendim profesional për këto çështje (p.sh. nga mjeku, psikologu, mësuesi ose ndonjë tjetër).

Intervista me prindërit/kujdestarët duhet të përqendrohet në mbledhjen e të dhënave mbi:

- Profilin e familjes (f. 3 nga Formulari 3 i MR)
- Kushtet e banimit (f. 4 nga Formulari 3 i MR)
- Ushqyerjen (f. 4 nga Formulari 3 i MR)
- Burimet e të ardhurave të ekonomisë familjare (f. 4 nga Formulari 3 i MR)
- Perceptimin e prindërve për punën e fëmijëve (f. 3 nga Formulari 3 i MR - Informacione të përgjithshme për prindërit)
- Qëllimet/perspektivën e prindërve për fëmijën e tyre (f. 10 nga Formulari 3 i MR -Indikacionet për planin e shërbimit)

Në këtë drejtim, duhet të vlerësohet edhe aftësia e familjes për të mbështetur tërheqjen dhe riintegrimin e fëmijës nga puna e fëmijëve: në çfarë mase është familja një faktor mbështetjeje dhe ndihme për rimëkëmbjen e fëmijës ose, përkundrazi, një pengesë. Nëse është e nevojshme duhet të organizohen intervista të veçanta me prindërit (nënë dhe babanë). Anëtarët e tjerë të familjes mund të intervistohen gjithashtu për të pasur një perspektivë më të gjerë të situatës.

Ky vlerësim duhet së pari të përcaktojë nëse fëmija është në rrezik të drejtpërdrejtë duke qëndruar pranë familjes së tij dhe nëse duhet të kërkohet një urdhër gjyqësor për një pezullim (të përkohshëm) të të drejtave prindërore²⁰. Çështjet që do të konsiderohen për vlerësimin e kapacitetit të prindërve për të mbështetur fëmijën përfshijnë të mëposhtmet:

- ✓ Perceptimi i prindërve për përvojën e punës së fëmijës dhe rolin e tyre në përvojën e punës së fëmijës;

²⁰ Në rastin kur kërkohet veprim juridik, faktet dhe provat e forta janë thelbësore për krijimin e një rasti kundër abuzuesit, trafikuesit ose të tjerëve të përfshirë, të cilat mund të çojnë në ndjekje penale përfundimtare në gjykatë.

Si parim, çdo përpjekje për të vërtetuar fakte dhe për të mbledhur prova kërkon një qasje të përqendruar te fëmija (viktima). Kështu, është e domosdoshme të kërkohet bashkëpunim nga secili anëtar i një ekipi shumë-disiplinor të profesionistëve të koordinuar nga Menaxheri i Rastit (mbrojtësi i viktimave, forenzika, policia, psikologu, psikiatri dhe avokati). Kjo është për të siguruar një përmbledhje gjithëpërfshirëse të provave materiale, shenjave dhe simptomave fizike dhe psikologjike dhe aspekteve sociale të rastit.

Për të vërtetuar efektet fizike dhe psikologjike te fëmija të shkaktuara nga abuzuesi, të gjitha format e provave, siç janë shënimet e shkruara, regjistrimet, fotografitë dhe provat e tjera materiale, duhet të mblidhen siç duhet, pa rrezikuar integritetin e provave. Në këtë drejtim, Menaxheri i Rastit duhet të punojë në bashkëpunim të ngushtë me policinë, zyrat e ekzaminimit mjekësor dhe mbrojtësin e viktimave. Në rastin e deklaratave të dhëna nga fëmija gjatë një interviste, çdo seancë duhet të regjistrohet në kasetë audio ose video, ose duke marrë shënime. Fëmija duhet të informohet se intervista do të regjistrohet. Është një praktikë standarde që intervistuesi të mos përdorë kurrë një pyetje drejtuese ose pyetje të mbyllura sepse çdo përgjigje ndaj pyetjeve të tilla bart më pak peshë në gjykatë. Mbani në mend se një deklaratë e bërë në fjalët e vetë të mbijetuarit në përgjigje të një pyetjeje të hapur ka më shumë peshë dhe është shumë më e dobishme për ndjekjen penale.

Vlerësimi gjithëpërfshirës i rastit

- ✓ Reagimi i prindërve ndaj traumës ose ngjarjes traumatike - *emocionale* (p.sh. zemërimi, dëshpërimi, mjerimi, faji), *kognitive* (p.sh. mohimi - “është e pamundur që diçka e tillë i ka ndodhur fëmijës tim”, *racionalizimi* - “fëmija im trillon gjëra ndonjëherë, kjo nuk mund të ketë ndodhur”) dhe *sjellja* (p.sh. ata janë tepër mbrojtës ose, përkundrazi, shumë të largët dhe të ftohtë me fëmijën);
- ✓ Mekanizmat mbrojtës të ndërtuar nga prindi i përfshirë në shfrytëzimin e fëmijës (“kjo ishte për të mirë të tij...”, “kjo është mënyra e vetme për të siguruar edukimin e tij”, etj.);
- ✓ Përvojat e mëparshme traumatike të prindërve që kanë modifikuar perceptimin e tyre të botës dhe normalitetit (p.sh. nëna ishte gjithashtu viktimë e abuzimit seksual ose punës shfrytëzuese);
- ✓ Si ka ndikuar përvoja e shfrytëzimit në familje, duke përfshirë marrëdhëniet me vëllezërit e motrat, marrëdhëniet brenda familjes, qëndrimin e fëmijës ndaj prindërve të tij, qëndrimin e prindërve ndaj fëmijës;
- ✓ Rreziku që fëmija të ri-viktimizohet nga prindërit e tij dhe aftësitë e prindërve për të qenë mbështetës dhe për të ndihmuar fëmijën e tyre gjatë gjithë procesit të rehabilitimit;
- ✓ Mënyra në të cilën prindërit janë të përfshirë në forcimin e strategjive dhe metodave të rehabilitimit (p.sh. nëse ata inkurajojnë dhe mbështesin fëmijën në rifillimin e shkollimit, nëse flasin me fëmijën për ndjenjat dhe mendimet e tij).

Të gjithë këta elementë duhet të merren parasysh me kujdes përpara se të merret një vendim për a) mbështetje të mundshme për familjen ose b) ndarje të mundshme të fëmijës nga familja.

Kujdes i duhur duhet t'i kushtohet vlerësimit të aftësive të prindërve për punësim ose angazhim në aktivitete të tjera të gjenerimit të të ardhurave (f. 3 nga Formulari 3 i MR - Informacione të përgjithshme për prindërit).

Disponueshmëria e shërbimeve, qasja e fëmijës në këto shërbime dhe qëndrimi i komunitetit ndaj punës së fëmijëve duhet të vlerësohet gjithashtu nga MR, nga këndvështrimi i ndikimit të tyre në angazhimin e fëmijës në punë (f. 8 nga Formulari 3 i MR).

Çdo seancë diskutimi ose këshilluese duhet të dokumentohet në mënyrë sistematike me (a) procesverbalin e takimit, (b) kohën, (c) vendin dhe (d) pjesëmarrësit e shënuar për regjistrim.

Faktet dhe provat e mbledhura përpilohen dhe merren në konsideratë nga MR për të marrë një profil të qartë të fëmijës, familjes dhe komunitetit ku jeton fëmija.

Një përshkrim i shkurtër i profilit të përgjithshëm të rastit bëhet në *përmbledhjen e vlerësimit të rastit* (f. 9 nga Formulari 3 i MR). Analiza e vlerësimit të kapacitetit dhe nevojave bëhet duke krahasuar të dhënat nga shkolla / familja / vendi i punës, në konsultim me fëmijën dhe familjen e tij.

Hapi 4: Plani i shërbimeve

Krijimi i një plani të shërbimeve është një përkthim i vlerësimit të kompetencave dhe nevojave të fëmijës në qëllime dhe synime konkrete dhe realiste, duke planifikuar një program trajtimi dhe rehabilitimi bazuar në shërbimet e disponueshme. Plani i shërbimit duhet të jetë baza e një kontrate morale midis fëmijës, prindërve, ofruesve të shërbimeve dhe Menaxherit të Rastit.

Kur përgatitni planin e shërbimeve, është e rëndësishme të mos shihni vetëm nevojat e fëmijës, por të njihni potencialin e tij për kapërcim të situatës. Në këtë drejtim, barrierat e identifikuar duhet të adresohen nga strategjitë për t'i kapërcyer ato dhe pikat e forta të identifikuar duhet të adresohen nga strategjitë për t'u mbështetur mbi to²¹. Një pjesë e këtij potenciali në të vërtetë mund të vijë nga përvoja e fëmijës si fëmijë punëtor. Për shembull, një fëmijë i trafikuar për të kënduar dhe lypur nëpër rrugë doli se kishte një zë të bukur dhe u drejtua në një shkollë profesionale të muzikës, si pjesë e procesit të tij të rehabilitimit. Sidoqoftë, MR duhet të jetë i kujdesshëm që riaktivizimi i përvojës së punës së fëmijës të mos riaktivizojë traumën e lidhur (nëse ka)²².

